



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË NPH "IBËR - LEPENC" SH.A PËR VITIN 2025

Prishtinë, maj 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të NPH "Ibër - Lepenc" sh.a për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të NPH "Ibër - Lepenc" sh.a (Ibër-Lepenci sh.a.), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2025, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes/ve së përshkruar në paragrafin Baza për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare të bashkangjitura për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pozitës financiare të NPH "Ibër - Lepenc" sh.a deri me 31 dhjetor 2025, performancës së saj, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2025, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Ndërmarrja në pasqyrat financiare më 31.12.2025 tek zëri i parapagimeve ka paraqitur shumën prej 2,820,901€ nga kjo shumë 934,216€ nuk i përkasin parapagimeve por pasurive të kushtëzuara. Rrjedhimisht për këtë shumë kemi mbivlerësim të pasurive afatshkurtëra.
- A2 Mbivlerësim i pasurisë si pasojë e mos zbatimit të amortizimit për dy muajt e vitit 2025, pas rivlerësimit në vlerë prej 300,189€.

- B1 Në vitin 2025 ndërmarrja ka kryer vlerësimin për herë të parë të pasurisë tokës dhe e ka njohur si pasuri në pasqyrat financiare me vlerë prej 25,438,800€. Si rezultat i këtij vlerësimi, ndërmarrja ka rritur fitimet e mbajtura për të njëjtën shumë (25,438,800 €). Megjithatë, ndërmarrja nuk ka njohur detyrimin për tatimin e shtyrë në vlerë prej 2,543,800€.

Në vitin 2025 ndërmarrja ka kryer vlerësimin për herë të parë të një pasurie afatgjatë në vlerë prej 1,547,952€, e cila në periudhat e mëparshme nuk ka qenë e regjistruar dhe as e paraqitur në pasqyrat financiare. Si rezultat i këtij veprimi, ndërmarrja ka rritur rezervën e rivlerësimit në kapital për 1,547,952€, nuk i ka rritur fitimet e mbajtur dhe nuk ka njohur detyrime për tatimin e shtyre ashtu siç kerkohet me standardin SNK 12 “Tatimi mbi të ardhurat”.

Shuma e rezervës së rivlerësimit e prezantuar në pasqyrat financiare ishte 202,404,505€, si rezultat i rritjes së vlerës së pasurive nga rivlerësimi i kryer në vitin 2007 në vlerë 162,424,909€, si dhe rivlerësimit të pasurisë në vlerë 39,979,596€ që ka ndodhur në vitin 2025, Ndërmarrja nuk kishte përlogaritur zhvlerësimin e rezervës rivlerësuese nga viti 2008 e këndej.

- B2 Ndërmarrja kishte prezantuar pronat e kategorisë tokë në PFV për vitin 2025. Gjashtë prona me sipërfaqe prej 21.1 hektarësh, janë në shfrytëzim nga ndërmarrja, por pa dëshmi të pronësisë; dy parcela me sipërfaqe prej 85.901 m² ku ndërmarrja nuk ka informacione se ku gjenden si lokacione dhe për çka shfrytëzohen; tre parcela me sipërfaqe 176.542 m² të cilat nuk shfrytëzohen nga NH Ibër Lepenc, në total pesë parcela me sipërfaqe prej 328,097 m² figurojnë në regjistrin e rivlerësimit të aseteve dhe në regjistrin e aseteve të ndërmarrjes, por nuk gjenden në regjistrin total të pronave nga katastra dhe nuk kanë certifikata të pronësisë; si dhe 58 parcela në Ribariq, Tutin - Novi Pazar, me sipërfaqe totale prej 167,531 m² të cilat janë në pronësi të ndërmarrjes, por ndodhen në territorin e Republikës së Serbisë por që edhe këto prona nuk ishin përfshirë në regjistrin e pasurive.
- B3 Të hyrat e shtyra nga grantet të prezantuara në pasqyrën e pozicionit financiar, reflektojnë me një diferencë në vlerë prej 159,784€ krahasuar me shënimet analitike që kanë derivuar nga mos përputhja në shënimet nga PFV të vitit 2024 e që kanë ndikim edhe në PFV 2025.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’.

Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion, transaksionet e kryera të NPH "Ibër - Lepenc" sh.a kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A3 Ndërmarrja ka aplikuar norma të papërshtatshme amortizimi për objektet ndërtimore dhe norma amortizimi jo të përshtatshme për pasuritë e paprekshme, duke mos respektuar standardet kontabël dhe politikat e brendshme të ndërmarrjes.
- A4 Procesi i rivlerësimit ka evidentuar dhe vlerësuar, ndër të tjera 6,808 parcela në pronësi të ndërmarrjes. Megjithatë, në regjistra kontabël të ndërmarrjes këto janë paraqitur si një zë i vetëm me vlerë totale, pa u regjistruar veçmas për secilën parcelë respektivisht si analitikë e regjistrit të pasurive.
- A5 Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara dhe mos amandamentim i kontratës.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'.

Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike, Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe raporti i auditorit mbi to

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet në raportin e menaxhmentit dhe deklaratën e qeverisjes korporative, por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditorit mbi këto pasqyra.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomali materiale.

Ne kemi marrë parasysh nëse informacionet në raportin për menaxhmentin janë në përputhje me informacionet në pasqyrat financiare dhe deklaratat e qeverisjes korporative përfshinë shpalosjet e kërkuara me nenet 7 dhe 10 të ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Nëse, bazuar në punën e kryer, arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të NPH "Ibër - Lepenc" sh.a.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i NPH "Ibër - Lepenc" sh.a është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të NPH "Ibër - Lepenc" sh.a në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.²

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ndërmarrja Publike Hidroekonomike "Ibër - Lepenc" sh.a me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të NPH "Ibër - Lepenc" sh.a.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruar të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e NPH "Ibër - Lepenc" sh.a, për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Çështjet apo gjetje që kanë ndikuar opinionin e pasqyrave financiare janë, trajtim i papërshtatshëm i rivlerësimit të pasurive afatgjata, trajtimi jo i duhur i zhvlerësimit (amortizimit) të pasurive afatgjat, klasifikimi i gabuar i parapagimeve dhe mos shpalosja e aktivitetit të kushtëzuar, mos prezantim i saktë i të hyrave të shtyra nga grantet. Çështjet të cilat kanë ndikuar në konkluzionin e pajtueshmërisë ishin Regjistrim përmbledhës dhe jo individual i tokave pas rivlerësimit, Mospërputhja ndërmjet regjistrave të parcelave të ndërmarrjes dhe të dhënave kadastrale zyrtare. Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Gjithashtu, ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 11 rekomandime, prej tyre shtatë janë rekomandime të reja dhe katër janë rekomandime të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Klasifikimi i gabuar i parapagimeve dhe mos shpalosja e aktivitetit të kushtëzuar

Gjetja

Sipas paragrafit 35 të SNK 37 Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivitetet e Kushtëzuara kërkon që "Aktivitetet e kushtëzuara vlerësohen vazhdimisht për të siguruar që zhvillimet janë reflektuar në mënyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare. Nëse do të jetë plotësisht e sigurt që do të bëhet një hyrje e përfitimeve ekonomike, aktivi dhe e ardhura që lidhet me të, njihen në pasqyrat financiare të periudhës në të cilën ka ndodhur ndryshimi. Në qoftë se ka qenë e mundur një hyrje e përfitimeve ekonomike, njësia ekonomike paraqet një aktiv të kushtëzuar".

Ndërmarrja ka paraqitur shumën prej 934,216€ si parapagime në pasqyrat financiare më 31.12.2025. Kjo shumë përfaqëson një avanc të dhënë në vitin 2022 ndaj një operatori për realizimin e një projekti, me të cilin ishte ndërprerë kontrata për shkak të mos kryerjes së punimeve. Ndërmarrja ka iniciuar procedura gjyqësore për kthimin e mjeteve, mirëpo deri në datën e raportimit nuk ka një vendim gjyqësor dhe nuk dihet vlera që mund të rikuperohet.

Mos azhurimi i regjistrave të kontabilitetit pas shkëputjes së kontratës ka shkaktuar mos vlerësimin e duhur të natyrës së kësaj llogarie dhe mos aplikimin korrekt të kërkesave të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.

Ndikimi Si rezultat i trajtimit të gabuar të zërit të parapagimeve, pasqyrat financiare janë të paraqitura gabimisht, pasi parapagimet janë mbivlerësuar dhe nuk është bërë shpalosja e duhur e një aktivi të kushtëzuar. Kjo ndikon në transparencën dhe besueshmërinë e raportimit financiar.

Rekomandimi A1 Bordi i Drejtorëve të sigurojë se trajtimi i parapagimeve të rishqyrtohet për shumat të cilat nuk i takojnë pasurive dhe ti trajtojë ato konformë SNK 37 për të shmangur mbivlerësimin e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mbivlerësimi i pasurisë si pasojë e mos amortizimit

Gjetja Bazuar në nenin 21 të Rregullorës Nr.01-4674 të datës 26.12.2025, ky nen përcakton parimet, procedurat dhe format standarde për llogaritjen, regjistrimin dhe raportimin e zhvlerësimit dhe amortizimit të pasurive të ndërmarrjes në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet dhe raportim financiar dhe auditim, pasuritë zhvlerësohen dhe amortizohen sipas metodës së aprovuar nga menaxhmenti dhe në pajtim me SNK/IFRS, regjistrimi i zhvlerësimit do të bëhet duke përdorur vlerën e re të drejtë dhe jetën e mbetur të përditësuar.

Pas përfundimit të rivlerësimit të pasurive në muajin tetor të vitit 2025, ndërmarrja me rastin e përlogaritjes së shpenzimeve të zhvlerësimiti nuk kishte arritur të zbatojë zhvlerësimin për dy muajt e fundit të vitit 2025.

Nga testimi i 70 mostrave, në 31 prej tyre kemi identifikuar mos llogaritjen e zhvlerësimit duke rezultuar në një vlerë totale të shpenzimeve të zhvlerësimit të pa zbatuar në vlerë prej 300,189€, rrjedhimisht pasuritë janë të mbivlerësuara për këtë vlerë.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i vonësës në miratimin e raportit të rivlerësimit dhe aktit juridik nga Bordi i Drejtorëve për normat e reja të amortizimit.

Ndikimi Amortizimi jo adekuat i pasurive duke mos marrë për bazë jetëgjatësinë e mbetur, ndikon në prezantimin jo të saktë të pasurive neto, shpenzimeve të amortizimit si dhe rezultatin financiar.

Rekomandimi A2 Bordi i Drejtorëve të sigurojë që amortizimi i pasurive të shpërndahet mbi baza sistematike të jetës së dobishme të mbetur të pasurisë pas rivlerësimit sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit. Më tutje, të sigurohet një rishikim i shpenzimeve të amortizimit si dhe korigjimi i gabimeve të identifikuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Prezantimi jo i saktë i PFV dhe i Rezervës së Rivlerësimit**Gjetja**

Sipas SNK 8 Politikat kontabël- gabimet Qëllimi paragrafi 4 Efektet tatimore të korrigjimeve të gabimeve të periudhës paraardhëse dhe rregullimet retrospektive të bëra për të zbatuar ndryshimet në politikat kontabël kontabilizohen dhe jepet informacion në përputhje me SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat dhe paragrafit 15 të standardit SNK 1 - Paraqitja e Pasqyrave financiare, PF duhet të paraqesin në mënyrë të drejtë gjendjen financiare të ndërmarrjes, Kjo nënkupton që shifrat e paraqitura në pasqyrat financiare duhet të jenë të sakta dhe të mbështetura në evidenca të besueshme,

Në vitin 2025 Ndërmarrja ka kryer vlerësimin e pasurisë- tokës, për here të parë, si rezultat i të cilës vlera e pasurisë është rritur dhe është prezantuar në pasqyra financiare në vlerë prej 25,438,800€. Megjithatë, ndërmarrja me këtë rast nuk e ka njohur në pozicionin e ekuitetit detyrimin për tatimin e shtyrë në vlerë prej 2,543,800€, ashtu siç kërkohet me SNK 12 Tatimit në të ardhura.

Ndërmarrja gjatë vitit 2025 kishte kryer vlerësimin e pasurive afatgjata si: Objekte ndërtimore, Hidrocentrale, Kanalet ujore, Pajisje makineri, Automobila dhe Pajisje tjera, në vlerë 1,547,952€, si rezultat ka njohur një rezervë rivlerësimi në vlerë 1,547,952€, në këtë rast është dashtë të rriten fitimet/ humbjet e bartura për këtë vlerë dhe të njihet në bilancin e gjendjes, pozicioni i ekuitetit nje detyrim i shtyrë ne vlerë 154,795€ ashtu siç kërkohet me SNK 12 Tatimi në të ardhura.

Shuma e rezervës së rivlerësimit e prezantuar në pasqyrat financiare ishte 202,404,505€, si rezultat i rritjes së vlerës së pasurive nga rivlerësimi i kryer në vitin 2007, si dhe pas rivlerësimit të pasurisë që ka ndodhur në vitin 2025, Megjithatë, kjo shumë nuk është korrigjuar në baza të rregullta për të reflektuar zhvlerësimin e pasurive për pjesën e vlerës së rritur pas rivlerësimit dhe duke zvogëluar rezervën rivlerësuese në këtë rast ndërmarrja ka njohur pasuritë të cilat janë vlerësuar për herë të parë në vlerë prej 1,547,952€ dhe ka rritur pozicionin e rezerves rivlerësuese per këtë vlerë ndërsa është dashtë të rritet pozicioni fitimet/ humbjet e bartura ndër vite. Në këtë rast pozicioni i rezervës rivlerësuese është mbivlerësuar për vlerën 1,547,952€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së procedurave të mjaftueshme të kontrollit dhe rishikimit të trajtimeve kontabël, për të siguruar që transaksionet e rëndësishme financiare të trajtohen në përputhje me standardet e raportimit financiar dhe kontabilitetit.

Ndikimi

Moszbatimi i kërkesave të standardeve kontabel rezulton në një klasifikim të pasaktë të rritjes së vlerës së pasurisë në pasqyrat financiare. Njohja e rritjes së vlerës nga rivlerësimi në fitim ose humbje, në vend që të regjistrohet në rezervën e rivlerësimit në kapital, shkakton mbivlerësim të rezultatit financiar të periudhës dhe paraqitje jo të saktë të strukturës së kapitalit të ndërmarrjes. Si pasojë, përdoruesit e pasqyrave financiare mund të marrin vendime ekonomike të bazuara në informacion financiar jo plotësisht të saktë.

Rekomandimi B1 Bordi i Drejtorëve të sigurojë korrigjimin e rezervës së rivlerësimit si rezultat i zhvlerësimit të akumuluar sipas kërkesave të standardeve, në mënyrë që pasqyrat financiare të prezantojnë pamje të drejtë dhe të vërtetë si dhe vlerësimi i pasurive për here te pare te behet ne pajtueshmeri te plote me kerkesat e standardit SNK 12 Tatimi ne te ardhura.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mungesa e përfshirjes së pasurive përkatësisht klasës së tokave në regjistrin e pasurive

Gjetja

Sipas SNK 16, kostoja e një aktivi afatgjatë material (toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje) do të njihet si aktiv nëse dhe vetëm nëse: (a) Është e mundshme që përfitimet ekonomike të ardhshme që i atribuohen atij aktivi do të rrjedhin te njësia ekonomike; dhe (b) Kostoja e aktivës mund të matet me besueshmëri. Tutje, toka dhe ndërtesat janë aktive të ndashme dhe trajtohen veçmas edhe nëse ata janë blerës së bashku. Me pak përjashtime të tilla si guroret dhe vendet e përdorura për mbushje, toka ka jetë të dobishme të pakufizuar dhe prandaj nuk amortizohet. Ndërtesat kanë jetë të dobishme të kufizuar dhe prandaj janë aktive të amortizueshme.

Gjatë auditimit kemi identifikuar se, megjithëse ndërmarrja ka kryer procesin e rivlerësimit të pasurive gjatë vitit 2025, duke identifikuar gjithsej 8,790 njësi me vlerë totale prej 146,065,000€, ajo ende nuk ka arritur të sigurojë një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurive të paluajtshme. Në kuadër të kësaj, ne kemi identifikuar se ndërmarrja në PFV nuk kishte prezantuar të gjitha pronat e kategorisë tokë për vitin 2025.

Parcelat (tokat) që nuk janë të regjistruara dhe pasqyruar në pasqyra financiare janë:

- gjashtë prona me sipërfaqe prej 21.1 hektarësh, janë në shfrytëzim nga ndërmarrja, por pa dëshmi të pronësisë;
- dy parcela me sipërfaqe prej 85.901 m² ku ndërmarrja nuk ka informacione se ku gjinden si lokacione dhe për çka shfrytëzohen;
- tre parcela me sipërfaqe 176.542 m² të cilat nuk shfrytëzohen nga NH Ibër Lepenc, në total 5 parcela me sipërfaqe prej 328,097 m² figurojnë në regjistrin e rivlerësimit të asetëve dhe në regjistrin e asetëve të ndërmarrjes, por nuk ginden në regjistrin total të pronave nga katastra dhe nuk kanë certifikata të pronësisë; si dhe
- 58 parcela në Ribariq, Tutin - Novi Pazar, me sipërfaqe totale prej 167,531 m² të cilat janë në pronësi të ndërmarrjes, por ndodhen në territorin e Republikës së Serbisë por që edhe këto prona nuk ishin përfshirë në regjistrin e pasurive.

Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e faktit se pronat e ndërmarrjes ndodhen në territorin e Serbisë, si dhe për shkak të vështirësive në qasjen përtej kufirit. Për më tepër, nuk kanë pasur mundësi për kompletimin e plotë të dokumentacionit përkatës, si dhe mungesë e evidencimit të plotë dhe të saktë të parcelave që janë në pronësi të ndërmarrjes.

Ndikimi Mangësitë në regjistrimin e tokave ndikojnë në saktësinë dhe besueshmërinë e raportimit financiar, duke rritur rrezikun e paraqitjes jo të drejtë të aseteve. Mungesa e dokumentacionit të pronësisë dhe mosregjistrimi i plotë i parcelave rrit rrezikun ligjor dhe humbjen e kontrollit mbi pasuritë, si dhe dobëson menaxhimin dhe vendimmarrjen e ndërmarrjes.

Rekomandimi B2 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë regjistrimin e të gjitha tokave të saj në pasqyrat financiare, duke respektuar standardet kontabël për pasuritë e paluajtshme. Për pronat që nuk kanë dëshmi të pronësisë, duhet të kryhet një verifikim ligjor dhe të ndërmerren masa për sigurimin e dokumentacionit përkatës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mos prezantim i saktë i të hyrave të shtyra nga grantet

Gjetja Sipas SNK 20, Kontabiliteti i granteve pika 24 përcakton se, grantet që lidhen me aktivet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, duhet të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë ose duke zbritur grantin që merret nga vlera e mbartur e aktivit. Po ashtu pika 17 përcakton se, grantet e marra për aktive të amortizueshme njihen si të ardhura gjatë periudhave në të cilat ngarkohet zhvlerësimi për ato mjete.

Në pasqyrën e pozicionit financiar, të hyrat e shtyra nga grantet janë prezantuar në vlerë 1,679,989€ duke mos rezultuar diferencën e identifikuar nga auditimi i PFV të vitit 2024 në vlerë prej 159,784€ të cilën ndërmarrja nuk kishte arritur të argumentojë as në vitin paraprak.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mos mbajtjes së evidencave të duhura në vitet e mëparshme e cila ka efekt edhe në PFV e vitit aktual, por edhe mos ndërmarrjes së hapave për korrigjimet e nevojshme.

Ndikimi Mangësitë e identifikuar për këtë zë, ndikojnë në prezantim dhe shpalosje jo të sakta të vlerës së granteve dhe rrjedhimisht edhe të pasqyrave financiare.

Rekomandimi B3 Bordi i Drejtorëve duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme korrigjuese lidhur me diferencën e granteve jo monetare dhe të forcojë kontrollin e brendshëm në ndërmarrje, me qëllim që informacionet financiare të komunikohen në kohë dhe të pasqyrohen në mënyrë të saktë në pasqyrat financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A3 - Dobësi në regjistrimin e pasurive

Gjetja

Bazuar në nenin 21 të Rregullorës Nr.01-4674 të datës 26.12.2025, ky nen përcakton parimet, procedurat dhe format standarde për llogaritjen, regjistrimin dhe raportimin e zhvlerësimit dhe amortizimit të pasurive të ndërmarrjes në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet dhe raportim financiar dhe auditim, pasuritë zhvlerësohen dhe amortizohen sipas metodës së aprovuar nga menaxhemti dhe në pajtim me SNK/IFRS, regjistrimi i zhvlerësimit do të bëhet duke përdorur vlerën e re të drejtë dhe jetën e mbetur të përditësuar.

Kemi identifikuar me rastin e përlllogaritjes së shpenzimeve të zhvlerësimit se normat për përlllogaritjen e shpenzimeve të zhvlerësimit nuk ishin adekuate me normat siq i parasheh rregullorja për kontabilitet dhe financa. Diga 1%, Kanalet Ujore , Ndërtesat dhe Objektet ndërtimore dhe Hidrocentrali me normë prej 2%, Pajisje Makineria me 5%, Automjete (Vetura dhe Kamiona) 10%, kompjuterë dhe pajisje të TIK me normë prej 20%.

Dobësitë e identifikuar, janë si në vijim:

- Në pesë mostra, me kosto fillestare totale prej 23,232,980€, ndërmarrja ka aplikuar norma zhvlerësimi prej 0.75% dhe 0.6% për kategorinë e objekteve ndërtimore. Megjithëse, sipas politikës së ndërmarrjes, norma e zhvlerësimit për këtë kategori duhet të jetë në intervalin 1%-2%.
- Për tri pasuri të paprekshme, me vlerë blerëse totale prej 88,815€, ishin aplikuar norma të ndryshme amortizimi, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe jetën e dobishme të këtyre pasurive. Ndërmarrja nuk kishte të përcaktuar një politikë për amortizimin e pasurive të paprekshme.

Kjo situatë është pasojë e regjistrimeve në vitet e mëparshme dhe mungesës së një politike të qartë dhe të mirëpërcaktuar për trajtimin dhe amortizimin e aseteve.

Ndikimi

Mos aplikimi i zhvlerësimit për pasuritë në shfrytëzim dhe përdorimi i normave jo adekuate të amortizimit, ndikon në mbivlerësimin e pasurive dhe nënvlerësimin e shpenzimeve të amortizimit. Po ashtu, mungesa e një politike për pasuritë e paprekshme rrezikon që shpenzimet e amortizimit të mos jenë të përshtatshme për këtë kategori.

Rekomandimi A3

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë kritere të qarta lidhur me trajtimin e pasurive në shfrytëzim dhe të aplikohen normat e duhura të zhvlerësimit, të cilat pasqyrojnë saktë konsumimin e përfitimeve ekonomike. Po ashtu, është e nevojshme të hartohet dhe zbatohet një politikë e qartë për zhvlerësimin e pasurive të pa-prekshme, që garanton pasqyrimin e saktë të shpenzimeve të amortizimit në pasqyrat financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A4 - Regjistrim përmbledhës dhe jo individual i tokave pas rivlerësimit****Gjetja**

Sipas SNK 16 Prona, Impiante dhe Pajisje paragrafi 37, kur një aktiv përbëhet nga pjesë të rëndësishme që mund të identifikohen veçmas, ato duhet të njihen dhe të regjistrohen individualisht në regjistrat kontabël. Për rrjedhojë, parcelat e tokës të cilat janë vlerësuar individualisht duhet të regjistrohen në regjistrin e asetëve si njësi të veçanta dhe jo vetëm si shumë totale.

Nga viti 2007, ndërmarrja tokat respektivisht parcelat përgjatë kanalit uxor i kishte njohur si pjesë integrale e zërit Kanalet ujore. Përgjatë vitit 2024 dhe 2025 për qëllime të ndarjes së këtij zëri, ndërmarrja kishte evidentuar rreth 6,808 prona/parcela toke.

Gjatë vitit 2025, ndërmarrja kishte angazhuar një kompani për rivlerësimin e asetëve, me këtë rast vlerësuesit kishin vlerësuar në mënyrë individuale të gjitha pronat/parcelat dhe vlera totale e këtyre 6,808 ishte vlerësuar për 25,438,000€. Mirëpo edhe pse ndërmarrja në PFV dhe shënime shpjeguese kishte paraqitur në mënyrë të duhur zërin e tokës, në regjistrat kontabël të veta respektivisht në regjistrin e asetëve nuk i kishte regjistruar parcelat në mënyrë individuale sipas vlerës së rivlerësuar, mirëpo i kishte regjistruar si total të zërit të tokës.

Mungesa e procedurave të qarta dhe aktiviteteve të rregullta të kontrollit të brendshëm ka bërë që parcelat e rivlerësuara të regjistrohen si një total i përbashkët, në vend që të shfaqen individualisht sipas vlerës së secilës.

Ndikimi

Mungesa e regjistrimit individual të parcelave kufizon efektivitetin e menaxhimit të brendshëm mbi asetet tokësore dhe e vështirëson kontrollin dhe vendimmarrjen mbi përdorimin dhe administrimin e tyre.

Rekomandimi A4

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që çdo parcelë toke të regjistrohet individualisht në regjistrin e pasurive sipas vlerës së rivlerësuar, duke forcuar kontrollet e brendshme dhe procedurat për evidentimin dhe menaxhimin e pasurive të paluajtshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara**Gjetja**

Sipas Rregullës Nr. 01/2022 për prokurim publik taksativisht në neni 70.23. pika b parashihet se menaxheri i kontratës duhet të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Në kontratat publike të nënshkruara mes ndërmarrjes dhe kontraktuesve, përcaktohen kushtet e veçanta kontraktuale si dhe afati kohor për realizimin e projektit. Menaxherët e kontratave duhet të monitorojnë dhe të sigurojnë se kontratat po realizohen si duhet dhe në afatin e përcaktuar. Në kontratat e nënshkruara ndërmjet ndërmarrjes publike dhe operatorëve ekonomik përcaktohet afati kohor për realizimin e punimeve.

Në dy raste, kemi vërejtur që punimet nuk ishin realizuar sipas planit dinamik, siç parashihej me kontratë:

- Kontrata "Rivlerësimi i Aseteve në ndërmarrjen publike NH 'Ibër Lepenc' Sh.a." në vlerë 89,900€ ishte nënshkruar me datë 10.02.2025. Sipas KVK, data e fillimit të punëve ishte planifikuar të kryhet për 6 muaj. Bazuar në raportin e monitorimit të kontratës data e fillimit të punëve ishte me 07.03.2025 derisa përfundimi 05.09.2025. OE kishte bërë kërkesë për shtyerjen e afatit e cila ishte miratuar nga Menaxherja e Prokurimit, por kjo zgjatje e afatit nuk kishte reflektuar tutje në amendamentim të kontratës. Nga OE projekti ishte dorëzuar me datë 17.10.2025.
- Kontrata "Renovimi i objektit të Drejtorisë të Ibër Lepenc" në vlerë 649,952€ ishte nënshkruar më 30.07.2025, përderisa punimet kishin filluar me 05.09.2025. Sipas KVK afati i kryerjes së punimeve ishte 90 ditë pune. Sipas kontratës, data e fillimit të punëve ishte menjëherë pas nënshkrimit 90 ditë të punës, dhe përfundimi ishte planifikuar për 6 muaj. Bazuar në raportin e monitorimit të kontratës data e fillimit të punëve ishte me 05.09.2025 derisa projekti ende nuk është përfunduar. OE me datë 17.10.2025 kishte bërë kërkesë për shtyerjen e afatit si dhe me 19.01.2026 kishin kërkuar përsëri shtyerje të afatit për punët shtesë dhe të paparashikuara deri më 26.02.2026 e cila ishte miratuar nga Menaxherja e Prokurimit me kontratë shtesë deri më 20.03.2026 por kjo zgjatje e afatit nuk kishte reflektuar përsëri në finalizimin e punimeve.

Me datë 30.04.2026 ne ishim në ekzaminim fizik të objektit dhe kemi identifikuar që punimet ende nuk ishin përfunduar. Edhe pse kjo ishte shtyerja e fundit dhe përfundimtare nuk ishte ndërprerë kontrata me këtë operator dhe nuk ishin zbatuar penalltitë për mos respektim të kontratës.

Kjo kishte ndodhur për shkak të punëve të paparashikuara dhe punëve shtesë që kishin dalur gjatë punimeve në objekt. Përderisa te rivlerësimi kjo kishte ndodhur si rezultat i vonesës së IL në dhënien e informatave OE për shkak të zhvendosjes nga objekti në renovim.

Ndikimi Mos respektimi i planit dinamik dhe mosmenaxhimi i duhur i ndryshimeve kontraktuale kanë ndikuar në zvarritjen e realizimit të projekteve, duke shkaktuar vonesa në arritjen e objektivave të ndërmarrjes. Mungesa e amandamentimit formal të kontratave dhe moszbatimi i penalteteve për mosrespektim të kushteve kontraktuale rrit rrezikun për keqmenaxhim të fondeve publike dhe krijon precedent negativ në menaxhimin e kontratave.

Rekomandimi A5 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë me një mbikëqyrje rigoroze në menaxhimin e kontratave. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat/ndëshkimet e parapara në kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pasuritë afatgjata

Vlera neto e zërit financiar të pasurive jo qarkulluese e prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar ishte 164,309,757€. Kategoritë e këtij zëri janë të përbëra nga: Penda e hidrocentralit, ndërtesat dhe objektet, kanalet ujore, pajisjet dhe makineritë si dhe investimet në vijim. Vlenë të ceket se në vitin raportues Ndërmarrja kishte kryer procesin e rivlerësimit të gjithë klasës së pasurive të paprekshme. Një veçori nga vitet e mëhershme është fakti se në këtë vit raportues ndërmarrja ka paraqitur ndaras zërin e tokës i cili më herët ishte pjesë integrale e zërit të kanaleve ujore. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale të detajeve në vlerë 5,780,496€ si dhe 10 mostra për teste të pajtueshmërisë. Përveç kësaj kemi kryer Procedurat analitike substanciale për popullacionin në tërësi sa i përket zhvlerësimit.

Çështja A6 - Mospërputhja ndërmjet regjistrave të parcelave të ndërmarrjes dhe të dhënave kadastrale zyrtare

Gjetja

Sipas paragrafit 15 të SNK 1” Pasqyrat financiare do të pasqyrojnë me drejtësi pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin monetar të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon një përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara në Kuadrin konceptual për raportimin financiar (Kuadri konceptual).” Aplikimi i SNRF-ve, me shënime shpjeguese shtesë kur është e nevojshme, supozohet se siguron pasqyra financiare që mundësojnë një paraqitje të drejtë” poashtu paragrafi 4.19 i kuadrit konceptual përcakton se “Kontrolli lidh një burim ekonomik me njësinë ekonomike. Vlerësimi nëse ekziston kontrolli ndihmon të identifikohet burimi ekonomik që i takon njësisë ekonomike.”

Ndërmarrja, gjatë vitit 2025, ka njohur për herë të parë tokën si aset në pasqyrat financiare. Vlera e tokës është përcaktuar nga një kompani e pavarur e vlerësimit e angazhuar në fund të vitit 2025 e cila ishte vlerësuar në vlerë prej 25,438.800€.

Gjatë auditimit janë identifikuar, këto çështje:

- Mospërputhje ndërmjet regjistrave të brendshëm të tokave të ndërmarrjes dhe të dhënave zyrtare kadastrale e poashtu edhe të dhënave në platformën zyrtare shtetërore për të dhënat kadastrale dhe gjeohapësinore gjegjësiht Geoportalin e Kosovës, ku disa parcela të regjistruara nga ndërmarrja nuk përputhen me evidencat kadastrale;
- Në 18 mostrat e testuara për zërin e tokës kemi vërejtur se vetëm 13 prej tyre kanë certifikata të pronësisë, gjersa 5 prej mostrave nuk kishin certifikata të pronësisë dhe kjo çështje ka rrezik që ndërmarrja të ketë paqartësi për statusin juridik të pronësisë së tyre.

Mungesa e harmonizimit ndërmjet regjistrave të brendshëm të ndërmarrjes dhe evidencave zyrtare kadastrale ka sjellë situatën që në disa raste të mos kei certifikata të pronësisë e poashtu edhe mospërputhje mes shënime të ndërmarrjes dhe të dhënave kadastrale.

- Ndikimi** Si pasojë e mospërputhjeve të identifikuara ekzistojnë pasiguri lidhur me dokumentacionin ligjor të tokës, e cila mund të ndikojë në saktësinë e paraqitjes së aktiveve dhe në shpalosjen e informacionit financiar.
- Rekomandimi A6** Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që dokumentacioni ligjor për të gjitha parcelat e tokës ekziston, në bashkëpunim me institucionet përkatëse të harmonizojë të dhënat kadastrale dhe regjistrin të aseteve dhe të regjistrojë në kontabilitet të gjitha asetet që plotësojnë kriteret e njohjes.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative janë realizuar në shumën 2,154,333€. Ato kanë të bëjnë me shpenzime të qirasë, mirëmbajtjes, marketingut, tarifat e licencës, shpenzimet e trajnimit dhe udhëtimit, shpenzimet e zyrës dhe ato administrative, shpenzimet e mjeteve motorike, shpenzimet për konsulencë, dhe të tjera. Kemi testuar 49 mostra për teste substanciale në shumën 1,361,895€.

Çështja A7 - Kosto shtesë për sigurim shëndetësor

Gjetja

Sipas SNK1 - Prezentimi i Pasqyrave Financiare, shpenzimet duhet të njihen në periudhën në të cilën ndodhin. Pagesat që lidhen me periudha të ardhshme duhet të njihen si aktive (shpenzime të parapaguara) dhe të shpërndahen sistematikisht gjatë periudhës përkatëse. Sipas Ligji Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, konkretisht: Neni 10 - Menaxhimi financiar dhe kontrolli, kërkon që organizatat të kenë kontrolle që sigurojnë se shpenzimet janë të arsyeshme, të justifikuara dhe të bazuara në të dhëna të sakta.

Ndërmarrja kishte lidhur kontratë për sigurim shëndetësor të punonjësve për periudhë tre vjeçare dhe gjatë muajit maj 2025 kishte kryer pagesë vjetore në vlerë prej 79,992€ si parapagim që mbulon periudhën 16.04.2025 - 15.04.2026. Nga analiza e shpenzimeve rezulton se shpërndarja e shpenzimit ishte bërë në mënyrë korrekte sipas parimit aktual, duke njohur vetëm pjesën që i takon vitit 2025 dhe duke evidentuar pjesën tjetër si shpenzim të parapaguar.

Megjithatë, kemi identifikuar se pagesa ishte realizuar për 300 punonjës, përkundër që numri mesatar i punonjësve në ndërmarrje gjatë vitit 2025 ka qenë 286, duke rezultuar në mbi pagesë për rreth 14 punonjës dhe një diferencë prej 2,666€, e cila nuk lidhet me përfitime reale dhe paraqet shpenzim të panevojshëm për ndërmarrjen.

Kjo diferencë në pagesë shtesë ka lindur në bazë të një marrëveshjeje për barazim në fund të periudhës kontraktuale, mirëpo në momentin e raportimit paraqet shpenzim të parapaguar që nuk lidhet me përfitime aktuale dhe kërkon monitorim për t'u siguruar rikuperimi apo kompensimi i saj në periudhat pasuese.

Ndikimi

Pagesa për 14 punonjës më shumë ka shkaktuar rritje të shpenzimeve të parapaguara dhe ulje të rezultatit financiar për vitin 2025, duke reflektuar një shpenzim që nuk lidhet me përfitime reale dhe që kërkon korigjim ose kompensim në periudhat pasuese për të siguruar paraqitje të drejtë të pasqyrave financiare.

Rekomandimi A7

Bordi i Drejtorëve të sigurojë vendosjen e kontrolleve të brendshme që garantojnë përputhjen e numrit të punonjësve të siguruar me numrin real mesatar gjatë periudhës së mbulimit, të verifikojë faturat para kryerjes së pagesës dhe të shqyrtojë mundësinë për rregullime kontraktuale që lejojnë fleksibilitet në numrin e punonjësve të mbuluar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Shpenzimet e pagave

Shpenzimet e pagave ishin 4.239.698€. Më 31 dhjetor 2025, Kompania ka pasur gjithsej 286 të punësuar.

Çështja B4 - Mangësi në ristrukturimin e ndërmarrjes

Gjetja Rregullorja e Brendshme Nr. 08/2913 e datës 31.10.2023 për sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, ndër tjera përcakton sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, përkufizon përgjegjësitë, kompetencat, autorizimet, koordinimin/ ndërlidhjen e përgjegjësive të stafit, me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe përgjegjshmërisë në kryerjen e detyrave si dhe përcakton nivelin e pagës e cila është e bazuar në poena.

Ndërmarrja edhe pse në vitin 2024 kishte përfunduar procesin e ristrukturimit, përkundër kësaj edhe gjatë vitit 2025 nuk kishte arritur t'i sistemojë pesë punonjës të cilët kishin kontrata të përhershme para sistematizimit. Kontratat e këtyre punonjësve nuk përputhen me pozitat e përshkruara në Rregulloren e re për sistematizim. Këta punonjës vazhdojnë ende të punojnë dhe të paguhen sipas kontratave të vjetra.

Kjo kishte ndodhur për shkak të ndryshimit të strukturës organizative dhe sistematizimit të vendeve të punës sipas rregullore së re për sistematizim si dhe mos përshtatjes së kualifikimeve të punonjësve me rregulloren aktuale.

Ndikimi Mangësitë e identifikuar mund të sjellin paqartësi në menaxhimin e resurseve dhe mund të ndikojnë negativisht në motivimin e punonjësve dhe arritjen e objektivave brenda organizatës.

Rekomandimi B4 Bordi i Drejtorëve duhet të ndërmerr veprime për trajtimin e stafit të pa sistemuar dhe të siguroj që kontratat në harmoni me rregulloren.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 të NPH "Ibër-Lepenc" sh.a. ka rezultuar me 11 rekomandime kryesore. Raporti i auditimit ishte kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit, përderisa menaxhmenti i ndërmarrjes ka përgatitur planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, pesë rekomandime janë zbatuar, dy të tjera janë të mbyllura dhe katër rekomandime nuk ishin zbatuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih Tabelën vijuese.

Grafiku 1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

| Nr | Fusha e Auditimit | Rekomandimet e vitit 2024 | Veprimet e ndërmarra | Statusi |
|----|-------------------|---|---|----------------------------|
| 1. | Baza për opinion | Bordi i Drejtorëve të sigurojë, korrigjimin e rezervës së rivlerësimit si rezultat i zhvlerësimit të akumuluar sipas kërkesave të standardeve, në mënyrë që pasqyrat financiare të prezantojnë pamje të drejtë dhe të vërtetë. | Kjo çështje është trajtuar tek e gjatura B1 në raportin e vitit 2025 | Nuk është i aplikueshëm më |
| 2. | Baza për opinion | Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë regjistrimin e të gjitha tokave të saj në pasqyrat financiare, duke respektuar standardet kontabël për pasuritë e paluajtshme. Për pronat që nuk kanë dëshmi të pronësisë, duhet të kryhet një verifikim ligjor dhe të ndërmerren masa për sigurimin e dokumentacionit përkatës. | Kjo çështje është trajtuar tek çështja B1 në raportin e auditimit të vitit 2025.. | Nuk është i aplikueshëm më |

| | | | | |
|----|---------------------|--|--|--------------------------|
| 3. | Baza për opinion | Bordi i Drejtorëve duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme korrigjuese lidhur me diferencën e granteve jo monetare dhe të forcojë kontrollin e brendshëm në ndërmarrje, me qëllim që informacionet financiare të komunikohen në kohë dhe të pasqyrohen në mënyrë të saktë në pasqyrat financiare. | Ndërmarrja kishte bërë korrigjimin e vlerës në shënimet kontabël për shpenzimet e projektit, por që nuk kishte arritur as në vitin 2025 të reflektojë per diferencën në shënimet kontabël të vitit paraprak. | Nuk ka filluar zbatimimi |
| 4. | Baza për opinion | Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë kritere të qarta lidhur me trajtimin e pasurive në shfrytëzim dhe të aplikohen normat e duhura të zhvlerësimit, të cilat pasqyrojnë saktë konsumimin e përfitimeve ekonomike. Po ashtu, është e nevojshme të hartohet dhe zbatohet një politikë e qartë për zhvlerësimin e pasurive të paprekshme, që garanton pasqyrimin e saktë të shpenzimeve të amortizimit në pasqyrat financiare. | Gjatë vitit 2025 gjendja është e njëjtë. | Nuk ka filluar zbatimimi |
| 5. | Baza për opinion | Bordi i Drejtorëve të sigurojë që në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, të bëhet rivlerësimi i pasurive të ndërmarrjes, me qëllim të prezantimit të vlerës së drejtë të tyre në Pasqyrat Financiare Vjetore. | Ndërmarrja kishte ndërmarrë veprime dhe kishte bërë rivlerësimin e pasurive në vitin 2025. | I zbatuar |
| 6. | Baza për opinion | Bordi i Drejtorëve të sigurojë që amortizimi i pasurive të shpërndahet mbi baza sistematike të jetës së dobishme të mbetur të pasurisë pas rivlerësimit sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit. Më tutje, të sigurohet një rishikim i shpenzimeve të amortizimit si dhe korrigjimi i gabimeve të identifikuar. | Edhe gjatë vitit 2025 gjendja është e njëjtë. | Nuk ka filluar zbatimimi |
| 7. | Baza për konkluzion | Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që njësia kërkuese të hartojë specifika të qarta dhe çdo ndryshim të trajtohet dhe përditësohet zyrtarisht në dosjen e tenderit. Gjithashtu, pagesa duhet të bëhet vetëm për mallrat që janë në përputhje të plotë me specifikat dhe kushtet e kontratës. | Gjatë vitit 2025 nuk kemi hasur në raste të tjera. | I zbatuar |

| | | | | |
|-----|-----------------------|---|---|-------------------------|
| 8. | Baza për konkluzion | Bordi i Drejtorëve duhet të ndërmerr veprime për trajtimin e stafit të pa sistemuar dhe të sigurojë që kontratat në harmoni me rregulloren. | Ndërmarrja kishte ulur numrin e punonjësve të pasistemuar me rregulloren e re, por që nuk kishte arritur që këtë proces të finalizojë deri në fund. | Nuk ka filluar zbatimin |
| 9. | Baza për konkluzion | Bordi i Drejtorëve në rast të ristrukturimit duhet të vendos procedurë të detajuara për përcaktimin e pozitave të cilat konsiderohen si të rëndësishme së veçantë në ndërmarrje dhe të bëjë analiza të mirëfillta për ristrukturim të stafit. | Gjatë vitit 2025 nuk kishte pako vullnetare të daljes nga puna. | I zbatuar |
| 10. | Baza për konkluzion | Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të gjitha aktivitetet të përfshihen në planin e prokurimit. Nëse lind nevoja për një aktivitet që nuk është parashikuar në këtë plan, duhet të njoftojë AQP-në për të shqyrtuar mundësinë e procedurave alternative dhe për t'u siguruar që fondet përdoren në mënyrë sa më efektive. | Gjatë vitit 2025 nuk kemi hasur në raste të tilla. | I zbatuar |
| 11. | Detyrimet afatshkurta | Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që furnitori të bëjë korrigjimin e faturave për të pasqyruar saktë shumën që i përket punës së ofruar, duke e përputhur atë me regjistrimet kontabël. | Gjatë vitit 2025 nuk kemi hasur në raste të tilla. | I zbatuar |

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Neslihane Mati, Udhëheqëse e ekipit



Fidane Shala Haxhiu, Anëtare e ekipit



Fejzullah Fejza, Anëtar i ekipit



Besa Morina, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

 N.H.P. „IBËR-LEPENC” SH.A.
D.D.
01-1278 Dt. 30.06.2026
PRISHTINË-PRISHTINA



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE “IBËR - LEPENC” SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE “IBËR - LEPENC” J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE “IBËR - LEPENC” D.D.

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të NHP “Ibër - Lepenc” sh.a, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Bajram Mustafa

Kryesues i Bordit të Drejtorëve, NHP “Ibër Lepenc” sh.a

Data: 29 prill.2026, Prishtinë,





NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEÇE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bil Clinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Clinton" Br.13 Prishtina, Kosovo
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

Raporti i Pasqyrave Financiare për Vitin 2025

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e 2-të të rregullt të mbajtur me datë 18.03.2026, pas shqyrtimit të Raporti i Pasqyrave Financiare për Vitin 2025 mori vendim për aprovimin e këtij raporti dhe kërkoi që i njëjti të përcillet në NJPMNP.

| | Delegoi | Aprovoi |
|------------------|----------------------|-----------------------------------|
| Emri Mbiemri | Kryeshefi Ekzekutiv: | Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve: |
| Nënshkrimi | Faruk MUJKA | Bajram MUSTAFA |
| Data: 18.03.2026 | | |



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

**Ndërmarrja Hidroekonomike "IBËR LEPENC" SH.A.
PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR
ME 31 DHJETOR 2025**

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
(Vlerat e shprehura në euro)

Tabela e përmbajtjes:

| | |
|---|---|
| Deklarata e pajtueshmërisë..... | 3 |
| Pasqyra e pozitës financiare..... | 4 |
| Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse..... | 6 |
| Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet..... | 7 |
| Pasqyra e rrjedhës së parasë..... | 8 |
| Shënimet e pasqyrave financiare..... | 9 |

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
(Vlerat e shprehura në euro)

Tabela e përmbajtjes:

| | |
|---|---|
| Deklarata e pajtueshmërisë----- | 3 |
| Pasqyra e pozitës financiare----- | 4 |
| Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse----- | 6 |
| Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet----- | 7 |
| Pasqyra e rrjedhës së parasë----- | 8 |
| Shënimet e pasqyrave financiare----- | 9 |

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
(Vlerat e shprehura në euro)

Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" Sh.A.
Adresa: Sheshi "Bill Clinton" Nr.13 - 10000, Prishtinë
NUI: 811280015

DEKLARATË E PAJTUESHMËRISË
Për pasqyrat financiare që përfundojnë më 31 Dhjetor 2025

Bazuar në njohuritë tona më të mira, deklarojmë që pasqyrat financiare që përfundojnë më 31 Dhjetor 2025, paraqesin në mënyrë të drejtë dhe të vërtetë pozicionin financiar të kompanisë, rezultatit e saj financiar dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në këtë datë në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Prishtinë, Republika e Kosovës
13 mars 2026

Faruk Mujka

Kryeshef Ekzekutiv

Enver Bajçinca

Zyrtar Kryesor Financiar

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
 (Vlerat e shprehura në euro)

| Pasqyra e pozitës financiare me 31 Dhjetor 2025 | | | | |
|--|---------------|------------------------|------------------------|------------------------|
| Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor | Shënim | 31 Dhjetor 2025 | 31 Dhjetor 2024 | 01 janar 2024 * |
| | | (në Euro) | (në Euro) | (në Euro) |
| PASURITË | | | | |
| Pasuritë afatshkurtëra | | | | |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë | 6 | 22,982,988 | 16,905,273 | 10,028,082 |
| Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera | 7 | 1,613,903 | 3,932,055 | 5,480,513 |
| Stoqet | 8 | 1,273,707 | 1,316,263 | 1,213,134 |
| Pasuritë tjera afatshkurtëra Parapagimet | 9 | 2,820,901 | 1,808,985 | 2,073,201 |
| Gjithsejt pasuritë afatshkurtëra | | 28,691,500 | 23,962,576 | 18,794,929 |
| Pasuritë afatgjata | | | | |
| Prona, pajisjet dhe implantet | 10 | 149,576,006 | 112,840,020 | 92,385,334 |
| Pasuria e paprekshme | 11 | 77,126 | 40,985 | 35,408 |
| Investimet në vijim BB | 12 | 14,656,624 | 11,085,841 | 5,863,709 |
| Gjithsejt pasuritë afatgjata | | 164,309,757 | 123,966,846 | 98,284,451 |
| GJITHSEJ PASURITË | | 193,001,257 | 147,929,422 | 117,079,381 |
| DETYRIMET DHE EKUITETI | | | | |
| DETYRIMET | | | | |
| Detyrimet afatshkurtëra | | | | |
| Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera | 13 | 2,583,756 | 1,426,457 | 851,945 |
| Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër | 14 | 661,399 | 608,020 | 562,810 |
| Tatimet e pagueshme aktuale | 15 | 154,797 | 22,623 | 21,607 |
| Të hyrat e shtyra nga përmbarimi | 16 | 1,143 | 631 | 647 |
| Të hyrat e shtyra nga donacionet | 17 | 1,679,989 | 1,344,321 | 1,371,067 |
| Perfitimet e punonjesve të pagueshme | 18 | 47,170 | 33,047 | 27,966 |
| Gjithsejt detyrimet afatshkurtëra | | 5,128,253 | 3,435,099 | 2,836,043 |
| Detyrimet afatgjata | | | | |

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
(Vlerat e shprehura në euro)

| | | | | |
|--|----|--------------------|--------------------|--------------------|
| Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë | 19 | 12,067,092 | 10,428,911 | 7,124,169 |
| Gjithsej detyrimet afatgjata | | 12,067,092 | 10,428,911 | 7,124,169 |
| GJITHSEJ DETYRIMET | | 17,195,344 | 13,864,010 | 9,960,212 |
| EKUITETI | | | | |
| Kapitali aksionar | 20 | 25,000 | 25,000 | 25,000 |
| Fitimet (Humbjet) e mbajtura | 21 | (28,384,497) | (29,891,940) | (55,961,837) |
| Fitimet (Humbjet) e vitit | | 1,760,905 | 1,507,443 | 631,097 |
| Rezervat tjera | | 202,404,505 | 162,424,910 | 162,424,909 |
| Korigjimi i rezervës së rivlerësimit | | | | |
| Gjithsej EKUITETI | | 175,805,912 | 134,065,412 | 107,119,169 |
| Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet | | 193,001,257 | 147,929,422 | 117,079,381 |

* Është parrgjitur pasqyra e pozicionit të tretë financiar për shkak të rishikimit të vitit 2024

Faruk Mujka

Kryeshf Ekzekutiv

Enver Bajçinca

Zyrtar Kryesor Financiar

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
 (Vlerat e shprehura në euro)

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

| | Shënimet | 31 Dhjetor 2025 (në Euro) | 31 Dhjetor 2024 (në Euro) |
|--|----------|------------------------------|------------------------------|
| Të hyrat | 22 | 12,332,741 | 11,100,812 |
| Të hyrat tjera | 23 | 33,087 | 70,270 |
| Fitimi/Humbja bruto | | 12,365,828 | 11,171,082 |
| Shpenzimet e zhvleresimit | 10&12 | (4,623,380) | (4,614,963) |
| Shpenzimet e personelit | 24 | (4,239,821) | (3,590,734) |
| Shpenzimet administrative | 25 | (827,290) | (513,097) |
| Shpenzimet operative | 26 | (169,471) | (129,186) |
| Shpenzimet e taksave | 27 | (765,010) | (562,828) |
| Shpenzimet e donacioneve | | | |
| Gjithsej shpenzimet operative | | (10,624,972) | (9,410,808) |
| Fitimi/(Humbja) operativ-e | | 1,740,856 | 1,760,274 |
| Shpenzimet financiare | | | |
| Shpenzimet e Interesit | 28 | (166,399) | (113,020) |
| Të ardhurat financiare | 29 | 412,611 | 174,864 |
| Fitimi/(Humbja) para tatimit | | 1,987,069 | 1,822,118 |
| Shpenzimet e tatimit në fitim | 30 | (226,164) | |
| Shpenzimet nga dëmi në infrastrukturë | | 0 | (314,675) |
| Fitimi/(Humbja) i/e vitit | | 1,760,905 | 1,507,443 |
| Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit | | | |
| Gjithsej të ardhurat/(humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit | | 1,760,905 | 1,507,443 |

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
(Vlerat e shprehura në euro)

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2025

| | Kapitali aksionar € | Fitimet e mbajtura € | Rezervat tjera € | Gjithsej € |
|--------------------------------------|---------------------------|----------------------------|------------------------|--------------------|
| Gjendja me 01 janar 2024 | <u>25000</u> | <u>(55,330,740)</u> | <u>162,424,910</u> | <u>107,119,170</u> |
| Fitimi/(humbja) i/e vitit | | 1,507,443 | | 1,507,443 |
| Korrigjim. Fitimet e mbajtura - Toka | | 25,438,800 | | 25,438,800 |
| Ndryshimi i rezervës së rivlersuar | | | | |
| Dividendat | | | | |
| Deponimet e kapitalit shtesë | | | | |
| Ndarja e rezervave | | | | |
| Gjendja me 31 Dhjetor 2024 | <u>25000</u> | <u>(29,891,940)</u> | <u>162,424,910</u> | <u>132,557,970</u> |
| Fitimi/(humbja) i/e vitit | | 1,760,905 | | 1,760,905 |
| Korrigjim. Fitimet e mbajtura - Toka | | | | |
| Ndryshimi i rezervës së rivlersuar | | | 39,979,595 | |
| Dividendat | | | | |
| Deponimet e kapitalit shtesë | | | | |
| Ndarja e rezervave | | | | |
| Gjendja me 31 Dhjetor 2025 | <u>25000</u> | <u>(28,131,035)</u> | <u>202,404,505</u> | <u>174,298,470</u> |

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
(Vlerat e shprehura në euro)

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË 2025

| Për vitin që përfundon me | Shënim | 2025 | 2024 |
|---|--------|-------------------|-------------------|
| I. Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative | | | |
| Fitimi (humbja) neto e vitit | | 1,760,905 | 1,507,443 |
| <i>Të rregulluara për:</i> | | | |
| Zhvierësimi | | 4,623,380 | 4,614,963 |
| Shpenzimet e Interesit | | 166,399 | 113,020 |
| Shpenzimet e tatimit në fillim | | | |
| Fitimi (humbja) para interesit, tatimit dhe zhvierësimit | | 6,550,684 | 6,235,426 |
| Lëvizjet në kapitalin qarkullues | | | |
| (Rritja)/zvogëlimi në llogaritë e arkëtueshme tregtare | | 2,318,152 | 1,548,457 |
| (Rritja)/zvogëlimi në stoqe | | 42,557 | -103,129 |
| Rritja/(zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera | | 1,303,596 | 580,608 |
| Rritja/(zvogëlimi) në parapagime | | -1,011,917 | 264,216 |
| Të hyrat e shtyera | | 336,180 | -26,762 |
| Interesi i paguar | | -166,399 | -113,020 |
| Ndryshimi i vlerës së pronës investuese-korrigjim | | 0 | 316,364 |
| Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative (I) | | 9,372,853 | 8,702,160 |
| II. Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese | | | |
| Blerjet e pronës, impianteve dhe pajisjeve | | -4,986,696 | -5,174,922 |
| Blerja e pasurisë së paprekshme | | 0 | |
| Shitjet e pronës, impianteve dhe pajisjeve | | | |
| Investimet tjera në pronë, impiante dhe pajisje | | | |
| Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese (II) | | -4,986,696 | -5,174,922 |
| III. Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese | | | |
| Të hyrat e shtyera nga donacionet | | | |
| Pjesa afatshkurtër e huamarrjeve afatgjata | | | |
| Pjesa afatgjate e huamarrjes | | 1,691,558 | 3,349,953 |
| Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese (III) | | 1,691,558 | 3,349,953 |
| IV. Rritja neto në para dhe ekuivalentët e parasë (I + II + III) | | 6,077,715 | 6,877,190 |
| V. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit | | 16,905,273 | 10,028,082 |
| VI. Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit (IV + V) | | 22,982,988 | 16,905,273 |

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
(Vlerat e shprehura në euro)

1. NFORMATA TË PËRGJITHSHME

N.H "Ibër-Lepenc" SH.A. është konstituar në vitin 1986 si Ndërmarrje Shoqërore me qëllim të operimit dhe mirëmbajtjes të infrastrukturës të këtij sistemi shumë funksional. Më vonë është transformuar në Ndërmarrje Publike nga UNMIK-u. Në vitin 2007 me përfundimin e korporatizimit ndërmarrja ka marrë statusin e shoqërisë aksionare dhe është kategorizuar si ndërmarrje publike qendrore. Në vitin 2007 në "Ibër Lepenc" ka përfunduar procesi i korporatizimit me të cilin është kryer edhe procesi i vlerësimit të asetëve dhe kështu nga data 1 janar 2008 ndërmarrja është regjistruar si shoqëri aksionare me emrin NH "Ibër Lepenc" – Sh.A. Prishtinë. Në ndërkohë, me kërkesë të Njësisë për Politika dhe Monitorin të Ndërmarrjeve Publike, me qëllim të zbatimit të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 03/74 të datës 14.07.2009 dhe Vendimit të Komisionit të Ministrave Nr. 218/1 të datës 30.09.2009, më 22.10.2009, janë kryer ndryshimet në statutin e ndërmarrjes sipas të cilave është shuar ish Ndërmarrja Holding dhe është sqaruar se NH "Ibër-Lepenc" SH.A. është trashëgimtare e ish-Ndërmarrjes Publike dhe ish-Ndërmarrjes Holding. Në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike ndërmarrja udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve dhe Kryeshefi Ekzekutiv i cili zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve, i cili ka kompetenca ekzekutive e që njëherit është edhe zyrtari më i lartë në ndërmarrje. Ligji për Shoqëritë Tregtare (Ligji nr. 02/L-123) dhe Ligji për Ndërmarrjet Publike (Ligji nr. 03/L-087) të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës janë aktet më të rëndësishme të cilat e rregullojnë menaxhimin e ndërmarrjes.

Veprimtaria kryesore e kompanisë është furnizimi me ujë të patrajtuar për qëllime të ujitjes së sipërfaqeve bujqësore, për kompanitë rajonale të ujësjellësve, për shfrytëzuesit industrial dhe gjeneron e shet energji elektrike nga hidrocentrali në Ujman.

Numri i të punësuarve në fund të vitit 2025 është 287 (2024: 265).

Selia qendrore e ndërmarrjes është në Prishtinë, Sheshi "Bill Clinton", nr.13, Kosovë.

2. BAZA E PËRGATITJES

(a) Deklaratë e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) siç janë publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me koston historike e modifikuar për paraqitjen e pronës, impianteve dhe pajisjeve në vlerën e rivlerësuar gjatë vitit 2025.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Valuta raportuese në evidencën e NH "Ibër-Lepenc" SH.A. dhe pasqyrat financiare është valuta Euro (€). Transaksionet në valuta tjera përveç euros nëse ka pasur janë të regjistruara sipas kursit të këmbimit sipas datave të transaksioneve.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe i gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, si dhe të ardhurave dhe të shpenzimeve. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare, janë shpalosur në Shënimin 4 (I)

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
(Vlerat e shprehura në euro)

3. BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)

(j) Hipoteza e vijimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi supozimin se kompania do të përmbushë hipotezën e vijimësisë, e cila supozon se Kompania do të jetë në gjendje të realizojë pasuritë e saj dhe të përmbushë detyrimet e saj në operacionet normale të biznesit. Viti 2025 ka rezultuar me fitim para tatimit në vlerë 1,987,069 € dhe ky është një sinjal pozitiv i cili tregon që kompania do të vazhdojë operimin me qëndrueshmëri.

Aftësia e kompanisë për të përmbushur hipotezën e vijimësisë varet nga realizimi i objektivave dhe detyrave të përcaktuara në Planin vjetor të Biznesit të Kompanisë. Menaxhmenti beson se po merr të gjitha masat e nevojshme për të mbështetur qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e biznesit të Kompanisë në rrethanat aktuale. Menaxhmenti nuk ka qëllim ose nevojë të likuidojë ose kufizojë materialisht fushën e operacioneve të tij në të ardhmen.

Kompania ka aprovuar planin vjetor 2026 ku qëllimet dhe objektivat e Kompanisë u prezantuan në zgjerimin e veprimtarisë, rritjen e pasurive dhe rritjen e shfrytëzimit të kapaciteteve që do të siguronin qëndrueshmërinë e të ardhurave gjatë viteve të ardhshme.

Menaxhmenti konsideron se nuk ka paqartësi materiale në lidhje me vazhdimësinë e Kompanisë. Humbja e akumuluar rezulton nga shpenzimi vjetor i zhvlerësimit. Fluksit e parasë janë vërejtur dhe është analizuar që fluksit hyrëse / dalëse të parave janë në raportin e dëshiruar që kompania të ruajë likuiditetin e saj, pavarësisht se për sa i përket fluksit të parave, shpenzimi i zhvlerësimit është zë jo-monetar. Kompania ka përmirësuar operacionet dhe rezultatet gjatë periudhave të fundit, që është dëshmi e mjaftueshme që linja e pjesëmarrjes është përmbushur nga menaxhmenti i Kompanisë.

4. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

a. Prona, Implantet dhe Pajisjet

Të veçantat kryesore të politikave kontabël për këtë periudhë janë:

- Procesi i rivlerësimit të pasurisë i kryer në 2025, ka bërë që pasuritë të paraqiten me vlerën e drejtë, sipas standardit SNK 16;
- Përfshirja e pronës së tokave në Pasqyrat Financiare. Për këtë shkak, në pajtim me SNK 8 është bërë korrigjimi i pasqyrave financiare 2024, ku është përfshirë edhe pasqyra e tretë e pozicionit financiar më datë 01 janar 2024;
- Pas aprovimit të raportit të rivlerësimit nga kompania vlerësuese e pasurisë, Bordi i Drejtorëve të ndërmarrjes, në mbledhjen e mbajtur me 22.12.2025 ka miratuar Rregulloren për kontabilitet e financa nr. 01-4674, ku në nenin 21 ka bërë aprovimin e normave të reja të zhvlerësimit. Normat e reja të zhvlerësimit të pasurisë hyjnë në zbatim nga 01 janar 2026.

Zërat e pronave, implantëve dhe pajisjeve ekzistuese, ato që i përkasin periudhave respektive historike janë paraqitur me rivlerësimin e parë gjatë vitit 2007. Përveç kësaj pronat ekzistuese i janë nënshtruar rivlerësimit gjatë vitit 2025 dhe mbahen në rivlerësim bazuar në vlerësimin e bërë nga vlerësuesit e pavarur, zvogëluar për zhvlerësimin e akumuluar të mëpashëm. Efekti i rivlerësimit merret në llogarinë e kapitalit. Të gjitha pronat, implantet dhe pajisjet e tjera deklarohen me kosto minus zhvlerësim të akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së artikujve.

Kostot e mëvonshme përfshihen në vlerën kontabël të pasurisë ose njihen si një pasuri e veçantë, sipas rastit, vetëm kur është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me pasurinë do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e pasurisë mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën ato janë bërë.

Me rivlerësimin nga vlerësuesit e pavarur në vitin 2025, janë identifikuar pronat e tokës që gjenden në pronësi të NHP "Ibër Lepenc", dhe tashmë prona e tokës përfshihet në Pasqyrën e pozicionit financiar e veçantë me vlerë për herë të parë.

Toka nuk është zhvlerësuar. Zhvlerësimi për pasuritë tjera llogaritet duke përdorur metodën e drejtëvizore për të shpërndarë koston e tyre ose shumat e rivlerësuar në vlerat e tyre të mbetura gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar, si më poshtë:

| # | Përshkrimi i llojit të pasurisë | Viti 2024 | Viti 2023 | Ligji: Nr.06/L-105 TAK |
|---|-----------------------------------|-----------|-----------|------------------------|
| | | | | Viti 2011 |
| 1 | Objektet ndërtimore | 1% - 2% | 1% - 2% | 5% |
| 2 | Makinëritë e rënda | 5% - 15% | 5% - 15% | 10% |
| 3 | Automjetet | 5% - 20% | 5% - 20% | 20% |
| 4 | Pajisje të zyrës dhe kompjuterike | 10% - 20% | 10% - 20% | 20% |

Për pasuritë e paprekshme, është zbatuar norma e amortizimit prej 5%, si normë minimale e lejuar me Ligjin Nr.06/L-105 për TAK.

Vlera e reziduale dhe jetëgjatësia e pasurive janë rishikuar dhe përditësuar me procesin e kryer të rivlerësimit të pasurive në vitin 2025. Vlera kontabël e një pasurie shënohet menjëherë në shumën e rikuperueshme nëse vlera kontabël e pasurisë është më e madhe se vlera e parashikuar e rikuperueshme. Fitimet dhe humbjet nga heqjet përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël. Shtimet në vlerë të pasurive janë paraqitur në pjesën e kapitalit të pronarit në nënlogarinë e rezervës së rivlerësimit. Rëniat në vlerë të pasurive, përderisa ka rezervë të rivlerësimit e pakësojnë atë, në rastin se mungon rezervë e rivlerësimit, paraqitet si shpenzim në Pasqyrën e të ardhurave të gjithëmbarshme.

Pas aprovimit të raportit të rivlerësimit nga kompania vlerësuese e pasurisë, Bordi i Drejtorëve të ndërmarrjes, në mbledhjen e mbajtur me 22.12.2025 ka miratuar Rregulloren për kontabilitet e financa nr. 01-4674, ku në nenin 21 ka bërë arrovimin e normave të reja të zhvlerësimit, pas pranimit të Raportit të rivlerësimit të pasurisë.

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
(Vlerat e shprehura në euro)

Në nenin 21 të Rregullores janë aprovuar kateorizimi i ri i pasurisë me normat përkatëse të zhvlerësimit, që fillojnë të aplikohen nga data 01.01.2026, si vijon:

| Nr. | Përshkrimi | Normat për raportim financiar | Sipas Ligji në fuqi për tatimin në të ardhurat e korporatave |
|-----|---|-------------------------------|--|
| 1 | Toka | Nuk zhvlerësohet | |
| 2 | Diga | 1% | 5% |
| 3 | Kanalet ujore | 2% | 5% |
| 4 | Ndërtesat dhe objektet tjera ndërtimore | 2% | 5% |
| 5 | Hidrocentrali | 2% | 10% |
| 6 | Pajisjet makinerike | 5% | 10% |
| 7 | Automjetet (Velura dhe Kamiona) | 10% | 20% |
| 8 | Pajisjet e zyrës – mobilje dhe enterieri tjetër | 10% | 20% |
| 9 | Kompjuterët dhe pajisjet e TIK | 20% | 20% |
| 10 | Pasuria jomateriale | Sipas kohëzgjatjes | |

Pas rivlerësimit të pasurisë, normat e zhvlerësimit të pasurisë së rivlerësuar do të bazohen në vlerën e re dhe jetëgjatësinë e mbetur. Norma e re e zhvlerësimit do të llogaritet sipas formulës:

$$\text{Norma e zhvlerësimit (\%)} = \frac{100}{\text{Jetëgjatësia e mbetur}}$$

b. Dëmtimi i pasurive jo-financiare

Pasuritë që kanë një jetë të papërcaktuar të dobishme nuk i nënshtrohen zhvlerësimit dhe testohen çdo vit për dëmtim.

Pasuritë që i nënshtrohen zhvlerësimit shqyrtohen për dëmtim sa herë që ngjarje ose ndryshime në rrethana tregojnë se vlera kontabël nuk mund të rikuperohet. Një humbje nga dëmtimi njihet për shumën me të cilën vlera kontabël e pasurisë tejkalon shumën e rikuperueshme të saj. Shuma e rikuperueshme është më e vlerë më e lart e vlera e drejtë e një pasurie e zbritur për koston për të shitur dhe vlerën në përdorim. Për qëllime të vlerësimit të dëmtimit, pasuritë grupohen në nivelet më të ulëta për të cilat ekzistojnë rrejdha monetare të identifikueshme veç e veç (njësi gjeneruese të parave). Pasuritë jo-financiare që kanë pësuar dëmtim janë rishikuar për kthimin e mundshëm të dëmtimit në çdo datë raportimi.

c. Stoqet

Stoqet vlerësohen sipas koston më të ulët ose vlerës neto të realizuar, dhe raportohen jo më shumë se shumën e pritur të realizohet nga shitja ose përdorimi. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shijes gjatë rrjedhës së zakonshme të biznesit minus koston e vlerësuar të nevojshme për ta kryer shitjen. Kur kostoja e një artikulli të stoqeve e tejkalon vlerën neto të realizueshme, ky

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
(Vlerat e shprehura në euro)

tejkaimi do të evidentohet si humbje në pasqyrën e të ardhurave. Kostoja e stoqeve është e përcaktuar në bazë të formulës "I pari hyn - I pari del" apo FIFO që nënkupton se ndërmarrja stoqet e blera me çmimin e parë i trajton dalje të para.

d. Instrumentet Financiare

Njohja dhe çregjistrimi

Pasuritë dhe detyrimet financiare njihen kur Kompania bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit financiar.

Pasuritë financiare gregjistrohen kur të drejtat kontraktuale për flukset e parave nga pasuria financiare skadojnë, ose kur pasuria financiare edhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen.

Një detyrim financiar gregjistrohet kur shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

Klasifikimi dhe matja fillestare e pasurive financiare

Përveç atyre të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një material të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmimin e transaksionit në përputhje me SNRF 15, të gjitha pasuritë financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për shpenzimet e transaksionit (aty ku është e aplikueshme).

Pasuritë financiare, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumenta mbrojtëse, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- kostoja e amortizuar
- vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL)
- vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI)

Në peridhurat e prezentuara Kompania nuk ka ndonjë pasuri të kategorizuar si FVTPL dhe FVOCI.

Klasifikimi përcaktohet nga dy:

- modelin e biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e pasurisë financiare
- karakteristikat e rrjedhës së parasë kontraktuale të pasurisë financiare.

Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me pasuritë financiare që njihen në fitim ose humbje janë paraqitur brenda kostove financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjera financiare, me përjashtim të dëmtimit të të arkëtueshmeve tregtare që paraqiten brenda shpenzimeve të tjera.

Matja e mëposhme e pasurive financiare

Pasuritë financiare maten me koston e amortizuar nëse pasuritë plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë përcaktuar si FVTPL):

- ato mbahen brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale të saj
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Zbritja është lënë jashtë ku efekti i zbritjes është jomaterial. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj, të arkëtueshmet tregtare shumica e të arkëtueshmeve të tjera bien në këtë kategori të instrumenteve financiare

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
 (Vlerat e shprehura në euro)

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDPFH)

Pasuritë financiare që mbahen në një model biznesi të ndryshëm nga "të mbajtura për tu arkëtuar" ose "mbajtja për tu arkëtuar dhe shitur" kategorizohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes. Më tej, pavarësisht nga asetet financiare të modelit të biznesit, flukset monetare kontraktuale të të cilave nuk janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit, llogariten në FVTPL.

Pasuritë në këtë kategori maten me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje. Vlera e drejtë e pasurive financiare në këtë kategori përcaktohet duke iu referuar transaksioneve aktive të tregut ose duke përdorur një teknikë vlerësimi ku nuk ekziston një treg aktiv.

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera përmbledhëse (FVOCI)

Kompania llogarit pasuritë financiare në FVTPL nëse pasuritë plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- ato mbahen në një model biznesi, qëllimi i të cilit është "të mbajtura për tu arkëtuar" e parave të lidhura dhe shitjes
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të papaguar

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) do të riciklohet pas ç'regjistrimit të pasurisë.

Dëmtimi i pasurive financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritshme të kreditorëve - 'modelin e humbjes së pritshme kreditorëve (ECL)'. Kjo zëvendëson SNK 39 'modelin e humbjeve të ndochura'. Instrumentet në kuadër të fushëveprimit të kërkesave të reja përfshinin kreditë dhe pasuritë e tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar dhe FVOCI, llogaritë e arkëtueshme, pasuritë e kontraktuara të njohura dhe të matura sipas SNRF 15 dhe zotimet e huasë dhe disa kontrata të garancisë financiare (për emetuesin) nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve kreditorëve nuk është më e varur nga kompania që fillimisht identifikon një ngjarje të humbjes kreditorëve. Në vend të kësaj, kompania konsideron një gamë më të gjerë informacionesh gjatë vlerësimit të rrezikut kreditor dhe maljes së humbjeve të pritshme kreditorëve, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetshme që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një ndarje midis

- instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga fillimi njohjes ose që kanë rrezik të ulët kreditor ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kreditorit i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').
- 'Faza 3' do të mbulonte pasuritë financiare që kanë dëshmi objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve kreditorëve gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
(Vlerat e shprehura në euro)

e. Kompensimi i instrumenteve financiare

Pasuritë dhe detyrimet financiare janë kompensuar dhe shuma neto e raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar ku ekziston një e drejtë e zbatueshme me ligj për të kompensuar shumat e njohura dhe ekziston një qëllim për të shlyer në bazë neto ose për të realizuar pasuritë dhe për të shlyer detyrimin njëkohësisht.

f. Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme shprehen në vlerat e tyre të drejta, me zbritje të lejuara dhe lejime për dëmtim dhe të matura me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Një lejim për dëmtim e llogarive të arkëtueshme përcaktohet kur ekzistojnë prova objektive që Kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat e përcaktuara sipas kushteve origjinale të arkëtimit. Vështirësi të konsiderueshme financiare të debitorit, probabiliteti që debitori të hyjë në falimentim ose riorganizim financiar, dhe parazgjedhja ose delikuenca në pagesa konsiderohen tregues se e arkëtueshmja është dëmtuar. Lejimi për dëmtim bëhet në bazë të vjetërsisë së balancave të arkëtueshme dhe përvojës historike, dhe kur mbledhja e pjeshme ose e plotë e një llogarie të arkëtueshme konsiderohet të mos jetë më e mundshme. Vlera kontabël e pasurisë zvogëlohet përmes përdorimit të një llogarie lejimi, dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Kur një e arkëtueshme është e paarkëtueshme, ajo zbritet kundër llogarisë së lejimit të llogarive të arkëtueshme. Rikuperimet pasuese të shumave të shkruara më parë dhe këtimi i humbjes nga dëmtimi i njohur më parë, janë të ardhura të kredituara në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

g. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë e gatshme në llogaritë rrjedhëse të mbajtura në banka, paratë në dorë dhe çdo investim tjetër me likuiditet të lartë me maturime origjinale prej tre muaj ose më pak që janë lehtësisht të konvertueshme në shuma të njohura të parave të gatshme, dhe i nënshtrohen një rreziku të ulët të ndryshimeve në vlerë.

h. Detyrimet financiare

Detyrimet financiare të Kompanisë përfshijnë huazime dhe detyrime të tjera.

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë, dhe, kur është e përshtatshme, rregullohen për kostot e transaksionit, përveç nëse Kompania cakton një detyrim financiar me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç për derivatet dhe detyrimet financiare të përcaktuara në FVTPL, të cilat barten më pas në vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivate të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse).

Të gjitha tarifat që lidhen me interesin dhe, nëse është e aplikueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje, përfshihen në kostot e financimit ose të ardhurat nga financat.

Metoda efektive e interesit është një metodë e llogaritjes së koston së amortizuar të një detyrimi financiar dhe të shpërndarjes së shpenzimeve të interesit për periudhën përkatëse.

Norma efektive e interesit është ajo normë që zbrit saktësisht pagesat e parave të gatshme (përfshirë të gjitha tarifat dhe pikat e paguara ose të pranuar që përbëjnë një pjesë integrale të normës efektive të interesit, kostot e transaksionit dhe primet e tjera ose zbritjet) për gjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose (kur është e përshtatshme) një periudhë më e shkurtër, në vlerën kontabël neto të njohjes fillestare.

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
 (Vlerat e shprehura në euro)

i. Llogaritë e Pagueshme dhe detyrimet e tjera

Llogaritë e Pagueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

j. Huamarrjet

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerën e drejtë, neto të shpenzimeve të transaksionit të bëra. Huamarrjet mbarten më pas me koston e tyre të amortizuar; çdo ndryshim midis të ardhurave (neto i kostove të transaksionit) dhe vlera e shlyerjes njihet në Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse gjatë periudhës së huazimeve duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Tarifat e paguara për krijimin e lehtësirave të kredisë njihen si koston e transaksionit të kredisë në atë masë sa kanë ndodhur ose deri në fshirje të tërësishme. Në këtë rast, njihet si tarifë e shtyrë derisa të ndodhë fshirja. Në atë masë sa nuk ka prova që ka të ngjarë që disa ose të gjitha nga tarifatat të fshihen, tarifa kapitalizohet si parapagim për shërbimet e likuiditetit dhe amortizohet gjatë periudhës së objektit me të cilin ka të bëjë.

Huamarrjet klasifikohen si detyrime rrjedhëse, përveç nëse Kompania ka të drejtë të pakushtëzuar të shtyjë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar.

k. Kostot e huamarrjes

Kostot e përgjithshme dhe specifike të huamarrjes që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes, ndërtimit ose prodhimit të aseteve kualifikuese, të cilat janë asete që domosdoshmërisht marrin një periudhë të konsiderueshme kohore për t'u përgatitur për përdorimin ose shijjen e synuar të tyre, i shtohen kostos së atyre aktiveve, deri në atë kohë kur aktivet janë të gatshme për përdorimin ose shijjen e synuar të tyre. Të gjitha kostot e tjera të huamarrjes njihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato ndodhin.

l. Grantet dhe donacionet

Një grant njihet vetëm kur ekziston një siguri e arsyeshme që do të përmbushë kushtet e bashkangjitura me grantin dhe do të merret. Granti njihet si e ardhur gjatë periudhës së nevojshme për t'i përputhur ato me kostot e lidhura, për të cilat ato synojnë t'i kompensojnë, në mënyrë sistematike.

Nëse një grant bëhet i ripagueshëm, ai duhet të trajtohet si një ndryshim në vlerësim. Kur granti original në lidhje me të ardhurat, ripagimi duhet të aplikohet së pari kundër çdo kredie të shtyrë të pandryshuar të lidhur, dhe çdo tepricë duhet të trajtohet si shpenzim. Kur granti original është në lidhje me një pasuri, ripagimi duhet të trajtohet si rritja e vlerës kontabël të pasurisë ose zvogëlimi i bilanci të të ardhurave të shtyra. Zhvlerësimi kumulativ i cili do të ishte ngarkuar nëse nuk merret granti duhet të ngarkohet si shpenzim.

Një grant i arkëtueshëm si kompensim për kostot e bëra tashmë ose për ndihmë të menjëhershme financiare apo materiale, pa kosto të lidhura në të ardhmen, duhet të njihet si e ardhur në periudhën në të cilën është e arkëtueshme. Përfitimi i një granti me një normë të ulët interesi në treg trajtohet si një grant qeveritar i matur nga diferenca midis të ardhurave të pranuar dhe vlerave të drejta të kredisë bazuar në normat aktuale të interesit të tregut.

m. Kapitali aksionar, rezervat, fitimet e mbajtura / akumuluar (humbjet)

Kapitali aksionar

Kapitali i aksioneve përbëhet nga vlera e drejtë e konsideratës monetare të kontribuar nga aksionarët.

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
 (Vlerat e shprehura në euro)

Rezervat

Rezervat tërësisht përbëhen nga teprica e rivlerësimit, i cili fillimisht krijohet në datën e rivlerësimit të pronës, implantave dhe pajisjeve të Kompanisë, duke qenë ndryshimi midis rivlerësimit dhe kostos fillestare të pasurive.

Teprica e rivlerësimit të përfshirë në kapitalin e vet mund të transferohet drejtpërdrejt në fitimet e mbajtura kur teprica është realizuar. E gjithë teprica mund të realizohet në zhvlerësimin e plotë ose fshirjen e asetit. Sidoqoftë, disa prej tepricave mund të realizohen pasi asetit përdoret nga ndërmarrja; në një rast të tillë, shuma e tepricës së realizuar është ndryshimi midis zhvlerësimit bazuar në vlerën kontabël të rivlerësuar të asetit dhe zhvlerësimit bazuar në koston fillestare të asetit. Kalimi nga teprica e rivlerësimit në fitimet e mbajtura nuk bëhet përmes pasqyrës së të ardhurave.

Fitimi i mbajtur / (humbja) e akumuluar

Fitimet e mbajtura / (humbjet) e akumuluar përbëhen nga fitimet jo të shpërndara / humbjet e pambuluara nga periudhat e kaluara.

Në pajtim me SNK 8 Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet, pragrafin 26 të tij, në këtë vit në fitimet e mbajtura/ (humbjet) (rregullim i periudhave paraprake), përfshihet vlera e pronave të tokës, e cila për herë të parë paraqitet në Pasqyrat Financiare.

n. Tatimi mbi fitimin aktual dhe të shtyrë

Shpenzimi tatimor për periudhën është shuma e tatimit mbi fitimin aktual dhe të shtyrë.

Ngarkesa e tanishme e tatimit mbi të ardhurat llogaritet në bazë të ligjit tatimor të miratuar në datën e bilancit.

Tatimi i shtyrë sigurohet në mënyrë të plotë, duke përdorur metodën e detyrimit, mbi ndryshimet e përkohshme që lindin midis bazës tatimore të pasurive dhe detyrimeve dhe vlerave kontabël të tyre në pasqyrat financiare. Tatimi i shtyrë përcaktohet duke përdorur shkallën e tatimit e cila është miratuar në datën e bilancit dhe pritet të zbatohet kur asetit i lidhur me tatimin mbi fitimin e shtyrë është realizuar ose është shyer detyrimi i tatimit të shtyrë.

Pasuria tatimore e shtyrë njihet vetëm në atë masë sa është e mundshme që fitimet e ardhshme të tatueshme do të jenë në dispozicion, kundër të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme të zbritshme. Detyrimet tatimore të shtyra njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Asetet tatimore të shtyra dhe detyrimet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundshme që përfitimi tatimor i lidhur dhe detyrimi tatimor respektivisht, të realizohen. Taksat shtesë të të ardhurave që vijnë nga shpërndarja e dividendëve njihen në të njëjtën kohë kur njihet detyrimi për të paguar dividendin e lidhur.

Kompania nuk ka njohur ndonjë detyrim ose pasuri tatimore të shtyrë në datat e raportimit.

o. Perfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore

Kompania paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve kur arrijnë moshën për pension. Kontributet e Kompanisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

Pagesa e pushimit vjetor

Kompania njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të vlerësuara në lidhje me pushimet vjetore që pritet të paguhen në këmbim për shërbimin e punonjësve gjatë periudhës.

p. Provizionimet

Një provizion njihet kur Kompania ka një detyrim aktual si rezultat i një ngjarje të kaluar dhe ka të ngjarë që do të kërket një rrjedhje e burimeve që sjellin përfitime ekonomike për të shlyer detyrimin,

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
 (Vlerat e shprehura në euro)

dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrim. Provizionet rishikohen në çdo pasqyrë të datës së pozicionit financiar dhe rregullohen për të pasqyruar vlerësimin aktual më të mirë. Kur efekti i vlerës kohore të parasë është material, shuma e provizionit është vlera aktuale e shpenzimeve që pritet të kërkohen për shlyerjen e detyrimit. Provizionet nuk njihen për humbjet e ardhshme të operimit.

q. Njohja e të hyrave

Të hyrat maten bazuar në vlerësimin e specifikuar në kontratat e klientit dhe përjashtojnë shumat e mbledhura në emër të palëve të treta. Kompania njihet të ardhura kur transferon kontrollin mbi produktin ose shërbimin te klienti.

Me qëllim të njohjes së të hyrave, kompania ndjek procesin sipas 5 hapave:

1. Identifikimi i kontratës me konsumatorin
2. Identifikimi i obligimeve të performancës
3. Përcaktimi i çmimit të transaksionit
4. Shpërndarja e çmimit të transaksionit në obligime të performancës
5. Njohja e të hyrave kur përmbushen obligimet e performancës.

Të hyrat njihen ose në një moment në kohë ose brenda një periudhe të caktuar atëherë kur kompania përmbushë obligimet e performancës duke transferruar mallrat ose shërbimet e premtuara.

Shitja e mallrave

Të hyrat nga shitja e mallrave njihet në një moment në kohë atëherë kur konsumatori përfton kontrollin mbi mallrat, që zakonisht është në momentin e dërgesës.

Të hyrat tjera

Të hyrat tjera njihen kur pranohen ose kur e drejta për të pranuar pagesë është përcaktuar.

r. Njohja e shpenzimeve

Njohja e shpenzimeve bëhet vetëm kur pasuritë ekonomike të ndërmarrjes të shoqëruara me transaksione konsumohen për prodhimin e mallrave ose kryerjen e shërbimeve. Shpenzimet njihen në pasqyren e të ardhurave vetëm kur ato ndodhin sipas parimit akrual të kontabilitetit.

s. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare njihen mbi bazën e proporcionit në kohë që pasqyron rendimentin efektiv të asetëve. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huazimet dhe shpenzimet e paracaktuara të interesit për pagesa të vonuara. Kostot e huamarrjes njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv.

t. Detyrimet kontigjente dhe zotimet

Detyrimet kontigjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen nëse nuk është e largët mundësia e një rrjedhje burimesh që sjellin përfitime ekonomike. Një aset i kushlëzuar nuk njihet në pasqyrat financiare, por shpaloset kur një rritje e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

Shuma e një humbjeje kontigjente njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme do ta konfirmojnë atë, një detyrim i bërë si në pasqyrën e datës së pozicionit financiar dhe një vlerësim të arsyeshëm të shumës së humbjes që rezulton.

u. Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë e parave të gatshme, llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme është afërsisht e barabartë me vlerën kontabël për shkak të jetëgjatësisë së tyre afatshkurtër.

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
(Vlerat e shprehura në euro)

v. Palët e ndërlidhura

Palët e ndërlidhura përcaktohen si ato palë që kanë kontroll mbi njëra-tjetrën ose kanë një ndikim në vendimet financiare dhe operacionale të njëra-tjetrës. Për qëllime të zbulimit të pasqyrave financiare, aksionarët e Kompanisë dhe subjektet e tyre të lidhur konsiderohen palë të lidhura.

w. Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas fundvitit që japin informacion shtesë në lidhje me pozicionin e një kompanie në pasqyrën e pozicionit financiar (ngjarjet rregulluese) pasqyrohen në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas fundvitit që nuk rregullohen, shpalosen në shënime kur vlera është materiale.

x. Vlerësimet kritike të kontabilitetit dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit

Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën historike dhe faktorë të tjerë, përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme për të cilat besohet se janë të arsyeshme në rrethanat e krijuara. Kompania bën vlerësime dhe supozime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet e kontabilitetit që rezultojnë, jo domosdoshmërisht do të jenë të barabarta me rezultatet aktuale të lidhura. Vlerësimet dhe supozimet që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar një rregullim material të vlerës kontabël të aseteve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë adresuar më poshtë:

Jetëgjatësia e pronës, impianteve dhe pajisjeve

Siç përshkruhet në Shënimin 4 (a) më lart, Kompania rishikon jetën e vlefshme të dobishme të pasurisë dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportimi. Çdo ndryshim në përdorimin e vazhdueshëm të pronave ose faktor tjetër mund të ndikojë në jetën e dobishme të pasurive dhe, në përputhje me rrethanat, mund të ndryshojë ndjeshëm vlerën kontabël të atyre pasurive.

Provizioni për dëmtim të arkëtueshmeve dhe shlyerja e inventarit

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bën vlerësime për rikuperimin dhe realizimin e të arkëtueshmeve dhe inventarëve. Bazuar në këtë vlerësim, menaxhmenti regjistron një provizion të duhur për dëmtimin e të arkëtueshmeve dhe regjistron inventarët. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimi.

Tatimet

Shpenzimi i tatimit i kompanisë për aktivitetet e zakonshme është shuma e totalit të ngarkesave tatimore aktuale dhe të shtyra. Llogaritja e taksës totale të Kompanisë përfshin domosdoshmërisht një shkallë vlerësimi dhe gjykim në lidhje me disa pika, trajtimi tatimor i të cilave nuk mund të përcaktohet përfundimisht derisa të arrihet zgjidhja me autoritetin përkatës tatimor ose, sipas rastit, përmes një procesi zyrtar ligjor. Zgjidhja përfundimtare e disa prej këtyre zërave mund të krijojë pasqyrë materiale të të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe / ose variancave të rrjedhës së parasë

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
 (Vlerat e shprehura në euro)

5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

Faktorët e riskut financiar

Aktivitetet e kompanisë e vënë atë në një shumëllojshmëri të riskut financiar, duke përfshirë riskun e tregut, riskun e kredisë dhe riskun e likuiditetit. Menaxhimi i riskut të kompanisë përqëndrohet në pa-parashikueshmërinë e tregjeve dhe kërkon që të minimizoj efektet e mundshme negative mbi performansën e biznesit të kompanisë.

Menaxhimi i riskut kryhet nga Menaxhmenti i Kompanisë të bazuar në disa politika dhe procedura paraprakisht të aprovuara me shkrim që mbulon plotësisht menaxhimin e riskut, si edhe zona të veçanta, të tilla si risku i këmbimit valutor, riskut i normës së interesit, risku i kredisë, përdorimit të letrave me vlerë të përshtatshme dhe investimit përtej likuiditetit.

Risku i tregut

Risku i tregut është risk që ndryshon në çmimet e tregut, si dhe kurset e këmbimit të huaj, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit do të ndikojë në të ardhurat e kompanisë ose vlerën tjetër të instrumenteve financiare të saj. Objektivi i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimin ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, derisa optimizon kthimin.

Risku i monedhës

Në përgjithësi, Kompania nuk është e ekspozuar ndaj riskut të monedhës pasi që shumica e shitjeve të saj, blerjeve dhe huazimeve janë në valutën Euro.

Risku i kreditor

Risku kreditor është risk në humbjen financiare të kompanisë, nëse një klient ose pala tjetër e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij të kontraktuara, dhe lindin kryesisht nga të arkatueshme të kompanisë prej klientëve dhe investimeve në letra me vlerë.

Llogaritë e arkëtueshme tregtare

Ekspozimi i Kompanisë ndaj riskut të kredisë është i ndikuar kryesisht nga karakteristikat individuale të secilit klient. Ky ekspozim mund të varet nga risku i mos pagesës në industri dhe tregun e brendshëm në të cilën vepron Kompania.

Kompania krijon një lejim për dëmtimet që pasqyrojnë vlerësimet e saj të humbjeve të shikatuara në lidhje me të arkatueshmet tregtare, të arkatueshmet tjera dhe investimet. Komponentët kryesorë të këtyre lejimeve janë komponentë të veçantë të humbjes që ka të bëjë me ekspozimet individuale të rëndësishme, dhe një komponentë e përbashkët e humbjes e themeluar për asetet të ngjashme të kompanisë në lidhje me humbjet që kanë ndodhur, por ende të pa identifikuar. Lejimi për humbjet e përbashkëta është përcaktuar në bazë të të dhënave historike të statistikave të pagesave për asetet të ngjashme financiare.

Analiza e riskut të kredisë

Ekspozimi maksimal i kompanisë ndaj rrezikut të kredisë është i kufizuar në vlerën bartëse të aseteve financiare të njohura në datën e raportimit, të përmbledhura si më poshtë:

| Me 31 dhjetor | 2025 | 2024 |
|--|-------------------|-------------------|
| Pasuritë qarkulluese | | |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë | 22,982,988 | 16,905,273 |
| Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera | 1,613,903 | 3,932,055 |
| Pasuritë tjera afatshkurtëra - Parapagimet | 2,820,901 | 1,808,985 |
| Ekspozimi maksimal ndaj riskut kreditor | 25,870,598 | 22,646,312 |

Risku kreditor për para dhe ekuivalentët e parasë konsiderohet i papërfillshëm, pasi që partnerë janë bankat me reputacion të lartë.

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
 (Vlerat e shprehura në euro)

Risku i likuiditetit

Kompania menaxhon nevojat e saj të likuiditetit duke monitoruar kujdesshëm pagesat e borxheve për detyrimet financiare afatgjate, si dhe hyrjet e parave të parashikuara dhe daljet e parashë nga aktivitetet e përditshme të biznesit. Nevojat për likuiditetin monitorohen në kohë të ndryshme, në bazë ditore dhe javore, si edhe në bazë të një projektimi përsëritës 30 ditësh. Nevojat e likuiditetit afatgjatë për një periudhë në vrotim prej 180 ditësh dhe 360 ditësh identifikohet çdo muaj. Kërkesa neto e parave krahasohet me mundësitë në dispozicion të huamarrjes në mënyrë që të përcaktoj ndonjë tepriçë apo ndonjë mungesë.

Kjo analizë tregon se mundësitë e huamarrjes në dispozicion pritet të jenë të mjaftueshme gjatë periudhës në vrotim.

Më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024, detyrimet e kompanisë kishin maturitet të kontraktuar (duke përfshirë pagesat e interesit ku është e aplikueshme) të përmbledhur si më poshtë:

| Me 31 dhjetor | 2025 | 2024 |
|---|------------------|------------------|
| Detyrimet afatshkurtëra | | |
| Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera | 2,583,756 | 1,426,457 |
| Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër | 661,399 | 608,020 |
| Tatimet e pagueshme aktuale | 154,797 | 22,623 |
| Të hyrat e shtyra nga përmbartimi | 1,143 | 631 |
| Të hyrat e shtyra nga donacionet | 1,679,989 | 1,344,321 |
| Përfitimet e punonjesve të pagueshme | 47,170 | 33,047 |
| Gjithsej detyrimet afatshkurtëra | 2,583,756 | 3,435,099 |

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
 (Vlerat e shprehura në euro)

6. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË

| Më 31 dhjetor | 2025 | 2024 |
|-------------------------|-------------------|-------------------|
| Banka - BpB | 150,293 | 430,100 |
| Banka BKT | 906,935 | 1,873,281 |
| BKT W.B | 16,220 | 36,984 |
| Banka TEB | 8,257 | 10,046 |
| Banka - Banka Ekonomike | 193,213 | 382,712 |
| Depozita - BpB | 25,000 | 25,000 |
| Arka e W.B | 295 | 292 |
| Arka | 724 | 1,165 |
| NLB | 246,158 | 190,024 |
| BKT-afatizim | 1,000,000 | 1,000,000 |
| NLB -afatizim | 2,000,000 | 2,000,000 |
| CREDINS-afatizim | 3,000,000 | 3,000,000 |
| PCB - kursime | 2,800,000 | 2,800,000 |
| BE-afatizim | 1,000,000 | 1,000,000 |
| PCB Banka | 3,216,807 | 649,716 |
| CREDINS | 105,386 | 954 |
| PCB - Kolaterali | 5,000 | 5,000 |
| NLB-kursime | 1,005,505 | 1,500,000 |
| PCB-afatizim | 2,000,000 | 2,000,000 |
| PriBank Ll.Rrjedhëse | 303,197 | 0 |
| BPB Ll. e Afatizimit | 3,000,000 | 0 |
| PriBank Ll.Afatizim | 2,000,000 | 0 |
| Gjithsej | 22,982,988 | 16,905,273 |

7. LLOGARITË E ARKËTUESHME TREGTARE

| Më 31 dhjetor | 2025 | 2024 |
|--|---------|------------|
| Shitja e energjisë elektrike -FETD | (50) | (50.00) |
| Shitja e energjisë elektrike -ALPEX | 20,770 | 70,602.24 |
| Shitja e Ujit industrial - Kosova B dhe A | 65,810 | 129,495.47 |
| Të arkëtueshmet nga Ujijtja | 86,486 | 126,352.92 |
| KUR,,PRISHTINA,, Drenas | 14,090 | 24,950.68 |
| Kompania,,Ujesjellësi Regjional,,Mitrovicë | 759,435 | 763,319.55 |
| NEWCO FERRONIKELI Complex LL.C | (0) | 13,728.04 |
| KRU,,MITROVICA,,SH.A.-Vushtri | 282,983 | 284,605.02 |
| KUR,,PRISHTINA,,SH.A.-SHKABAJ | 66,232 | 135,442.12 |

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
 (Vlerat e shprehura në euro)

| | | |
|---|------------------|---------------------|
| KOSTT | 74,961 | 2,250,386.31 |
| Interesi i arktushem | 242,674 | 133,222.91 |
| Qiraja e arktusheme | 512 | |
| Llogaritë e arkëtueshme bruto | 1,613,903 | 3,932,055.26 |
| Provizionimi i llogarive të arkëtueshme | | |
| LLOGARITË E ARKËTUESHME | 1,613,903 | 3,932,055 |

Me 31 Dhjetor 2025 në bilancin e përgjithshëm të llogarive të arkëtueshme me klienti KRU Mitrovica kërkesa arrin në 1,042,419 (apo 65% e totalit të të arkëtueshmeve neto).

Ndërmarrja ka realizuar një Memorandum Bashkëpunimi mes tre palëve KRU "Mitrovica" Sh.A dhe NH "Ibër Lepenc" Sh.a dhe "Ministrisë së Ekonomisë". Qëllimi i këtij memorandumi është që palët kontraktuese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim të ndërsjellët, me të cilin synohet: programin I pagesave mujore, shmangie brenda mundësive të procedurave përmbarese për inkasim të borxhit si dhe angazhimi maksimal për shlyerje të borxhit paraprak të KRU " Mitrovica" Sh.A kundrejt kreditorit N.H "Ibër Lepenc" Sh.A.

8. STOQET

Gjendja e stoqeve është si në vijim:

| Me 31 dhjetor | 2025 | 2024 |
|-------------------|------------------|------------------|
| Material në depo | 1,240,226 | 1,295,827 |
| Inventari në depo | 26,445 | 12,739 |
| MHT në depo | 7,034 | 7,698 |
| Gjithsej | 1,273,707 | 1,316,263 |

Lëvizjet e stoqeve gjatë vitit janë si në vijim:

| Me 31 dhjetor | 2024 | 2024 |
|-----------------------|------------------|------------------|
| Stoqet në fillim | 1,316,263 | 1,213,134 |
| Blerjet gjatë vitit | 185,145 | 209,340 |
| Shpenzimet për stoqet | (227,702) | (106,211) |
| Gjithsej | 1,273,707 | 1,316,263 |

Stoqet me 31 dhjetor 2025 përbëhen nga pajsije hidrante, gypa për ujitje, mjete të punës, rrjeta të ujitjes, pjesë teknike për servis të stoqeve etj. Në ndërmarrje mbahen ekskluzivisht vetëm si pjesë rezervë për intervenime në objekte, mjete themelore dhe pajsije.

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
(Vlerat e shprehura në euro)

9 PARAPAGIMET DHE KËRKESAT

| Më 31 dhjetor | 2025 | 2024 |
|--|------------------|------------------|
| Projekti: Sigurimi i ujit dhe mbrojtja e kanalit | 934,216 | 934,216 |
| Parapagimi i TVSH-se | 1,584,431 | 839,598 |
| Parapagimet tjera | 302,255 | 35,170 |
| Gjithsej | 2,820,901 | 1,808,985 |

9. PARAPAGIMET DHE KËRKESAT

Parapagimet dhe kërkesat tjera afatshkurtëra paraqesin parapagimet e shpenzimeve nga Kompania.

10. PRONA, IMPIANTET DHE

| PAJISJET | | | | | |
|--|-------------------|------------------------|-----------------------|------------------------------|--------------------|
| Kosto me: | Toka | Objektet ndërtimore | Makineritë e rënda | Pajisjet dhe inventari | Gjithsej |
| Me 01 janar 2024 | = | 280,862,982 | 4,166,384 | 7,868,588 | 292,897,953 |
| Shtesat | | 206,335 | | 127,145 | 333,479 |
| Shitjet (heqjet) | | -464,781 | | -233,058 | -697,839 |
| Bartja në Investime në vijim | | -390,315 | | | -390,315 |
| Me 31 dhjetor 2024 | 25,438,800 | 280,214,221 | 4,166,384 | 7,762,675 | 292,143,278 |
| Shtesat | | 875,779 | 21,000 | 471,190 | 1,367,969 |
| Rivlersimi | | 0 | 0 | 0 | 39,979,595 |
| Shitjet (heqjet) | 0 | 0 | 0 | -46,824 | -46,824 |
| Me 31 dhjetor 2025 | 25,438,800 | 281,090,000 | 4,187,384 | 8,187,040 | 333,444,018 |
| <i>Zhvierësimi i akumuluar</i> | | | | | |
| Me 31 dhjetor 2023 | | - | -3,320,885 | - | -200,512,620 |
| Shpenzimi për periudhën (Heqje)/Korigjimi i zhvierësimit | | -4,458,684 | -83,022 | -71,209 | -4,610,914 |
| | | 150,106 | | 231,369 | 381,475 |
| Me 31 dhjetor 2024 | | - | -3,403,907 | - | -204,742,060 |
| Shpenzimi për periudhën (Heqje)/Korigjimi i zhvierësimit | | -4,441,345 | -83,267 | -85,798 | -4,610,410 |
| | | 0 | | 45,657 | 45,657 |
| Me 31 dhjetor 2025 | | - | -3,487,175 | - | -209,306,813 |
| | | 198,375,725 | | 7,443,914 | |

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
(Vlerat e shprehura në euro)

| | | | | | |
|--|-------------------|-------------------|----------------|----------------|--------------------|
| Vlera neto në libra më 31.12.2024 | 25,438,800 | 86,279,841 | 762,477 | 358,902 | 112,840,020 |
| Vlera neto në libra më 31.12.2025 | 25,438,800 | 82,714,275 | 700,209 | 743,126 | 149,576,006 |

Zërat që përbëjnë Pronën, Implantet dhe Pajisjet paraqesin objektet ndërtimore, makineritë e rënda, pajisjet dhe inventarin. Pasuritë e blera para datës 31 dhjetor 2024 dhe që ekzistojnë më 31 Dhjetor 2025 mbahen me shumën e vlerësuar, duke zbritur shumën e zhvlerësimit të akumuluar. Të gjithë artikujt e tjerë mbahen me kosto duke zbritur shumën e zhvlerësimit të akumuluar.

| | |
|---------------------------------|-----------------|
| 11. Pasuri e paprekshme | Softwear |
| Shtesat | 29,449 |
| Shijet (heqjet) | |
| Me 31 dhjetor 2025 | 29,449 |
| 11.1 Pasuri e paprekshme | Webfaqe |
| Me 31 dhjetor 2023 | 35,408 |
| Shtesat | 7,600 |
| Zhvlersimi | -2,023 |
| Me 31 dhjetor 2024 | 40,985 |
| Shtesat | 47,086 |
| Zhvlersimi | -10,945 |
| Me 31 dhjetor 2025 | 77,126 |

12. INVESTIMET NËN PROJEKTIN "Siguria e Ujit dhe Mbrojtja e Kanalit"

Më 27 Janar 2017 Qeveria e Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave (MF) - pranuesi dhe Shoqata Ndërkombëtare e Zhvillimit - Banka Botërore - Huadhënësi, hyri në marrëveshje financimi IDA Credit 5902 - XK), për të financuar Projektin Siguria për Ujin e Kosovës dhe Mbrojtjes së Kanalit ("Projekti"). Projekti zbatohet nga Iber-Lepenc ("I-L") dhe Ministria e Ekonomisë (ME). Më shumë detaje në lidhje me marrëveshjen financiare janë shpalosur në Shënimin 19 më poshtë.

Në bazë të marrëveshjes së huasë, Iber-Lepenc ka krijuar një Njësi të Koordinimit të Projektit (PCU) me funksione, staf dhe burime të kënaqshme për Shoqatën me qëllim të sigurimit të koordinimit të shpejtë dhe efikas të përgjithshëm, zbatimit të përditshëm dhe komunikimit në lidhje me aktivitetet dhe rezultatet e projektit.

Qëllimi i projektit është të kontribuojë në rivendosjen e Kanalit Ibër në kapacitetin e tij origjinal për të përmirësuar menaxhimin e burimeve ujore për përdoruesit e ndryshëm të ujit të kanalit në Kosovën Qendrore. Investimet e projektit paraqesin shpenzime të kapitalizuara të bëra për blerje të mallrave, punëve, shërbimeve jo-këshilluese, shërbimet e këshilltarëve dhe kostove inkrementale operative.

Lëvizja e flogarisë së investimit të projektit për periudhat e raportuara është si më poshtë:

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
 (Vlerat e shprehura në euro)

12. INVESTIMET NË VIJIM

| | Kosto | Zhvlerësimi i Akumuluar | Vlera Neto |
|---|-------------------|-------------------------|-------------------|
| Me 31 dhjetor 2023 | 6,830,306 | -966,597 | 5,863,709 |
| Shtesat BB | 4,833,843 | | 4,833,843 |
| Shtesa nga sanimi i kanalit Besi-B.Most | 390,315 | | 390,315 |
| Shitjet (heqjet) | | -2,025 | -2,025 |
| Me 31 dhjetor 2024 | 12,054,464 | -968,623 | 11,085,841 |
| Shtesat BB | 3,420,203 | | 3,420,203 |
| Investimet vijim jashtë BB | 152,604 | | 152,604 |
| Shitjet (heqjet) | | -2,025 | -2,025 |
| Me 31 dhjetor 2025 | 15,627,272 | -970,648 | 14,656,624 |

13.LLOGARITË E PAGUESHME TREGTARE

| Me 31 dhjetor | 2025 | 2024 |
|---|------------------|------------------|
| KES/CO PRISHTINA | 647 | 3,466 |
| KES/CO MITROVICË | 942 | 16,012 |
| POSTTELEKOMI I KOSOVES | 2,571 | 2,461 |
| MMPH MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPSINOR | 725,582 | 347,645 |
| Famis | 1,494,664 | 787,716 |
| Korporata Energjike e Kosoves sh.a | 12,774 | 0 |
| Furnitorë tjerë | 346,575 | 269,157 |
| Gjithsej | 2,583,756 | 1,426,457 |

14. KREDITË DHE HUATË, PJESA AFATSHKURTËR

| Me 31 dhjetor | 2024 | 2023 |
|---|----------------|----------------|
| Pjesa e detyrimit ndaj bankës për periudhen 1 vjecare | 661,399 | 608,020 |
| Gjithsej | 661,399 | 608,020 |

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
(Vlerat e shprehura në euro)

15. TATIMET E PAGUESHME

| Për vitin që përfundon me 31 dhjetor | 2025 | 2024 |
|--------------------------------------|----------------|---------------|
| Tatimi në paga dhe meditje | 34,872 | 22,623 |
| Tatimi ne Fitim | 119,925 | |
| TVSH e Pagushme | - | - |
| Gjithsej | 154,797 | 22,623 |

16. TË HYRAT E SHTYERA/ Permbarimi

| Më 31 dhjetor | 2025 | 2024 |
|--------------------|--------------|------------|
| Të hyrat e shtyera | 512 | 631 |
| Gjithsej | 1,143 | 631 |

| Më 31 dhjetor | 2025 | 2024 |
|------------------------------------|------------------|------------------|
| Gjithsej të hyra të shtyera | 1,681,132 | 1,344,952 |

17. TË HYRAT E SHTYERA NGA DONACIONET

| Emërtimi | Bilanci 2024 | Grantet 2025 | Shpenzimet 2025 | Bilanci 2025 |
|------------------------|------------------|-----------------|--------------------|------------------|
| Pajisje - themelore | 1,066,015 | 362,427 | -24,653 | 1,403,789 |
| Materiali | 278,306 | | -2106.1 | 276,200 |
| Gjithsej | 1,344,321 | 362,427 | -26,759 | 1,679,989 |

18. DETYRIMET NDAJ PERSONELIT

| Për vitin që përfundon me 31 dhjetor | 2025 | 2024 |
|--------------------------------------|---------------|---------------|
| Detyrimet ndaj pagave bonus | 1,132.59 | 1,177 |
| Detyrimet ndaj sindikatës | 2,294 | 2,026 |
| Meditjet e anëtarëve të Bordit | | |
| Kontributet pensionale | 43,743 | 29,843 |
| Gjithsej | 47,170 | 33,047 |

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
(Vlerat e shprehura në euro)

19. KREDITË DHE HUATË, PJESA AFATGJATË

Huamarrjet më 31 Dhjetor 2025, shuma prej 12,728,490 € ka të bëjë me kredinë e dhënë ndaj Kompanisë bazuar në marrëveshjen financiare IDA Credit 5902 - XK) të lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave (MF) - Pranuesi dhe International Development Association- Banka Botërore - Huadhënësi. Palët kontraktuese hynë në marrëveshjen e financimit për të financuar Projektin për Sigurinë e Ujit dhe Kanalin e Mbrojtjes të Kosovës ("Projekti").

Bilanci i huamarrjeve më 31 Dhjetor 2025 paraqet disa këste të gjithsej 15 milion EUR. NHP "Ibër Lepenci" do të paguajë shumën kryesore të Kredisë në këste gjysmë-vjetore përmes Qeverisë së Kosovës, në secilin 15 Prill dhe 15 Tetor, si vijon:

| Data e pagesës | Shuma e Principalit të pagueshëm |
|--|----------------------------------|
| Duke filluar nga 15 tetori 2021, deri dhe duke përfshirë, 15 Prill 2031 | 1.65% |
| Duke filluar nga 15 Prilli 2031, deri dhe duke përfshirë, 15 Prill 2041. | 3.35% |

| | 2025 | 2024 |
|--|-------------------|-------------------|
| Huamarrjet afatgjate që mbartin interes | | |
| IDA – Banka Botërore | 12,728,490 | 11,036,932 |
| Total huamarrjet | 12,728,490 | 11,036,932 |
| 12 Huamarrjet pjesa afatshkurter | | |
| Prej të cilave: | | |
| Pjesa afatshkurter e huamarrjeve afatgjate | 661,399 | 608,020 |
| Pjesa afatgjatë | 12,067,092 | 10,428,911 |

20. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali aksionari i kompanisë i prezentuar në pasqyrën e ndryshimeve të ekuitetit ka vlerën 25,000 Euro. Qeveria e Republikës së Kosovës posedon 100% të aksioneve të kompanisë.

21. FITIMI I MBAJTUR (HUMBJA E GRUMBULLUAR)

Gjatë procesit të rivlerësimit të pasurisë të kryer në fund të vitit 2025 nga vlerësues të pavarur, është bërë edhe vlerësimi i parcelave të tokës që ndërmarrja ka në pronësi të saj, gjë që ka mundësuar paraqitjen e saj në pasqyrat financiare, e të cilat nuk kanë qenë të paraqitura në periudhat e

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
 (Vlerat e shprehura në euro)

mëparshme. Për këto prona ekzistojnë certifikatat e pronësisë. Ky mosregjistrim është trajtuar si gabim i periudhave të mëparshme sipas SNK 8 (paragrafi 26) dhe është korrigjuar përmes riparimit retrospektive dhe rritjes (zvogëlimi) së fitimeve të mbajtura / (humbjes së grumbulluar) (në shumën 25,438,800 €. Është paraqitur edhe si pasqyrë e tretë e pozicionit financiar më 01.01.2024.

Ky korrigjim nuk ka efekt në fitimin e periudhës dhe nuk gjeneron ndikim tatimor.

Gjithashtu nuk ka pasur ndikim në pasqyrën e të ardhurave, fluksin e parasë apo rezervat e rivlerësimit.

| 22. TË HYRAT NGA AKTIVITETET | | |
|--|-------------------|-------------------|
| Për viti që përfundon me 31 dhjetor | 2025 | 2024 |
| Të hyrat nga shitja e energjisë elektrike | 9,080,773 | 8,191,614 |
| Të hyrat nga shitja e ujit industrial | 2,577,004 | 2,490,957 |
| Të hyrat nga ujitja | 235,406 | 192,788 |
| Të hyrat nga Jobalanca për HC Ujman | 439,559 | 226,453 |
| Gjithsej të hyrat nga aktivitetet operative (I) | 12,332,741 | 11,100,812 |

23. TË HYRAT TJERA

| Për viti që përfundon me 31 dhjetor | 2025 | 2024 |
|--|-------------------|-------------------|
| Të hyrat nga kamata (përmbaruesi) | 2,007 | 696 |
| Të hyrat nga donacionet | 26,759 | 69,574 |
| Të hyrat nga ndalesat e punëtorëve | 4,321 | - |
| Të hyrat nga interesi | 412,611 | 174,864 |
| Të hyrat tjera | - | - |
| Gjithsej të hyrat tjera (II) | 445,698 | 245,135 |
| Gjithsej të hyrat (I+II) | 12,778,439 | 11,345,946 |

24. SHPENZIMET E PERSONELIT

| Për viti që përfundon me 31 dhjetor | 2025 | 2024 |
|--|-------------|-------------|
| Pagat e rregullta | 2,788,867 | 2,135,089 |
| Pagat jashte orarit | 81,428 | 57,679 |
| Paga Jubilare | 0 | 0 |
| Pushimet mjekësore | 0 | 0 |
| Pagat përcjellëse | 9,918 | 44 |

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
 (Vlerat e shprehura në euro)

| | | |
|--------------------------------|------------------|------------------|
| Kompenzimet e veçanta (Shujta) | 271,280 | 232,632 |
| Sindikata | 11,549 | 9,662 |
| Tatimi në paga | 273,149 | 233,202 |
| Kontributi pensionale | 401,644 | 339,795 |
| Pagat e Bordit | 35,472 | 31,797 |
| Sigurimi Shëndetsor | 67,974 | 57,774 |
| Paga tjera Bonuse | 298,540 | 493,060 |
| Gjithsej | 4,239,821 | 3,590,734 |

25.SHPENZIMET ADMINISTRATIVE

| <u>Për vitin që përfundon me 31 dhjetor</u> | <u>2025</u> | <u>2024</u> |
|---|----------------|----------------|
| Udhëtime, medijtje, transport etj | 16,425 | 5,066 |
| Provizionet Bankare | 4,092 | 3,199 |
| Shpenzimet Komunale | 386,121 | 278,579 |
| Shpenzimet e telekomunikimit | 25,147 | 22,589 |
| Artikuj të përbashket, materiale për zyre dhe direkte | 51,612 | 49,461 |
| Shpenzimet e reprezentacionit | 17,690 | 13,581 |
| Shpenzimet per sherblime | 38,538 | 9,214 |
| Shpenzimet tjera të përbashkëta | 287,666 | 131,408 |
| Gjithsej | 827,290 | 513,097 |

26.SHPENZIMET OPERATIVE

| <u>Për vitin që përfundon me 31 dhjetor</u> | <u>2025</u> | <u>2024</u> |
|--|----------------|----------------|
| Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimeve | 62,493 | 37,193 |
| Shpenzimet e servisimit dhe kontrollit (AKZ) | 0 | |
| Sigurimi dhe regjistrimi i automjeteve | 14,103 | 11,634 |
| Material Hargjues | 26,295 | 28,922 |
| Shpenzimet e derivateve | 47,716 | 42,488 |
| Kompensimi i Dëmeve | 6,094 | 8,949 |
| Shpenzimet nga jobalanca HC UJMAN | 12,770 | 0 |
| Shpenzimet e energjisë elektrike | 0 | 0 |
| Gjithsej | 169,471 | 129,186 |

27.SHPENZIMET E TAKSAVE

| <u>Për vitin që përfundon me 31 dhjetor</u> | <u>2025</u> | <u>2024</u> |
|---|-------------|-------------|
|---|-------------|-------------|

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
(Vlerat e shprehura në euro)

| | | |
|--------------------------------------|----------------|----------------|
| Taksa per rregullatore dhe MMPH | 760,356 | 558,708 |
| Shpenzimet e kamatës dhe ndëshkimeve | | |
| Tatimi në prone | 4,654 | 4,120 |
| Gjithsej | 765,010 | 562,828 |

28. SHPENZIMET E INTERESIT

| Për vitin që përfundon me 31 dhjetor | 2025 | 2024 |
|--------------------------------------|----------------|----------------|
| Shpenzimet e interesit | 166,399 | 113,020 |
| Gjithsej | 166,399 | 113,020 |

29. TË ARDHURAT FINANCIARE

| Për vitin që përfundon me 31 dhjetor | 2025 | 2024 |
|--------------------------------------|----------------|----------------|
| Të ardhura nga interesi | 412,611 | 174,864 |
| Gjithsej | 412,611 | 174,864 |

30. SHPENZIMET E TATIMIT

| Me 31 dhjetor | 2025 | 2024 |
|--|---------------|----------|
| Fitimi para tatimit | 1987069 | 0 |
| Shpenzimet e pa zbritshme | 45,312 | 0 |
| Diferenca e pa zbritshme e zhvlersimit | 229,258 | 0 |
| Fitimi paratatimit i rregulluar | 2,261,639 | 0 |
| Tatimi | 226,164 | 0 |
| Parapagimi i TMB | 29,744 | 0 |
| Tremujorshat | 76,495 | 0 |
| Total Parapagimi i Tatimit | 106,239 | 0 |
| Detyrimi ndaj Tatimit Fitim | 119,925 | 0 |

NH IBËR LEPENC SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025
 (Vlerat e shprehura në euro)

31.DETYRIMET KONTIGJENTE DHE ZOTIMET

Çështjet gjyqësore

Vlera në Euro e çështjeve gjyqësore në proces aktiv ku ndërmarrja është e paditur, deri me datë 12.03.2026 është 955,225.88 €

Sqarim: Kjo vlerë është pretenduese nga paditësit dhe nuk mund të liqaritet si vlerë detyruese pasi që të gjitha lëndët janë në procedurë gjyqësore. Vlenë të theksohet se ka lëndë të cilat ende nuk është dhënë vlera e pretenduar pasi që për të nxirren ekspertiza gjyqësore gjatw proceduvs dhe si rrjedhojë kjo vlerë do të ndryshoj.

Vlera në Euro e çështjeve gjyqësore ku ndërmarrja është paditëse deri me datë 12.03.2026 është: **2,213,504.15 €** ku nga kjo vlerë 2,164,397.84 euro janë sigurimi i ekzekutimit dhe sigurimi i avansit lidhur me projektin e B.B. ku është paditur kompania e sigurimeve "Sigal" por që nga Gjykata Komeriale në një tjetër procedurë ka caktuar "masën e sigurimit" e propozuar nga kontraktuesi "Gener 2" dhe rasti është në revizion në Gjykatën Supreme. Vlenë të theksohet se ndërmarrja ka lëndë në procedurë ku kërkesa është për lirim të pronave nga uzurpuesit që do të thotë në këtë rast kemi kërkuar lirimin e pronës e jo kundërvlerë.

Sqarim: Kjo vlerë është pretenduese dhe jo përfundimtare pasi që të gjitha lëndët janë në procedurë gjyqësore dhe poashtu ka lënd të cilat ende nuk është dhënë vlera e pretenduar.

Lëndët në procedurë përbarimore ku ndërmarrja është kreditore janë në vlerë 48,425.69€. Kjo vlerë ka të bëjë kryesisht me borxhe për ujllje dhe paisje të ujlljes. NH "Ibër Lepenc" debitorin kryesor në procedurë përbarimore e ka KRU "Mitrovica"Sh.A. për furnizim me ujë industrial të papërpunuar për detyrimet deri në Qershor 2021. Vlera e kërkesës në tërësi në procedurë përbarimore për lëndet aktive për KRU "Mitrovica" ishte është 785,078.17€ prej të cilave janë paguar 498,506.53€ deri me tani dhe pretendojm të realizohen pagesat sipas marrëveshjes edhe në vlerën e mbetur 287,220.64€, pasi që ndërmarrja ka hyrë në marrëveshje me datë 29.08.2023 e cila marrëveshje ka hyrë në zbatim nga datë 01.08.2023 për pagesë me 48 këste ku vlera e kësllit është 13,272.69 euro.

Sqarim : Në total i bie se ndërmarrja është në procedurë gjyqësore/përbarimore si paditës/kreditor në vlerë : 2,549,150.48€ ndërsa e paditur në vlerë 955,225.88 €

32. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Pas 31 Dhjetorit 2025 dhe deri në nxjerrjen e këtyre pasqyrave financiare, nuk ka ngjarje të tjera që do të kishin nevojë për shpalosje ose korigjime në këto pasqyra financiare.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante.
- ² Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet